



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 15 regjistër (JR)  
Datë 14.04.2023

Nr. 58 i vendimit  
Datë 21.07.2025

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Relator</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 21.07.2025, ditën e hënë, ora 10:30 në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Jerina Gjika, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 15/2023 (JR), datë 14.04.2023, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Saimir Bahiti, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 612, datë 13.01.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Saimir Bahiti.

**BAZA LIGJORE:** Neni F i Aneksit të Kushtetutës, nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës; nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; neni 442 e vijues i “Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”.

## Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ( në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit Saimir Bahiti të paraqitura në ankim dhe në parashtrimet me shkrim të depozituara në Kolegji, i cili kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimin nr. 612, datë 13.01.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Saimir Bahiti (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, ai iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente, brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës dhe formularin për vetëvlerësimin profesional.
3. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin; (ii) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) ka kryer deklaram të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
4. Drejtoria e Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, si dhe dërgoi pranë Komisionit një raport të arsyetuar me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 2.11.2017, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 6.2.2020, të KDZH-së, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit grupi i punës pranë DSIK-së ka arritur në konkluzionin për përshtatshmërinë e vazhdimit të detyrës.
5. Grupi i punës i ngritur pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.

6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe grupi i punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Saimir Bahiti, bazuar në tri kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale).

## **II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

7. Komisioni, me vendimin nr. 612, datë 13.01.2023, vendosi: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Saimir Bahiti, prokuror pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.*

8. Ky vendim është marrë nga Komisioni bazuar në konkluzionet e mëposhtme.

➤ Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë: *Në përfundim të hetimit administrativ, me qëllim evidentimin e mundësisë së subjektit dhe familjes së tij për të krijuar pasuritë dhe likuiditetet gjatë periudhës së detyrës si prokuror, Komisioni kreu analizën financiare, sipas së cilës ka rezultuar se pamundësia totale e subjektit për të krijuar pasuritë dhe për të kryer të gjitha shpenzimet e evidentuara është (-) 3.739.738 lekë. Kjo balancë i përkiste vetëm vitit 2012 kur është bërë pasuria apartament. Në përfundim të procesit, pas rishikimit të analizës financiare, kjo balancë bëhet (-) 736.659 lekë, pasi [...]: (i) shuma 21.493,55 euro paguar pranë BKT-së në datën 3.12.2012, nuk u konsiderua si shpenzim i subjektit mbi shumën 104.000 euro; (ii) huaja prej shtetasit S. A. në vlerën prej 1.200.000 lekësh, marrë në vitin 2012, nuk u konsiderua si burim i ligjshëm për blerjen e pasurisë apartament. Kjo balancë nuk konsiderohet penalizuese në vlerësimin e kriterit pasuror.*

➤ Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës: *Në vlerësimin përfundimtar, bazuar në standardet e kontrollit të figurës të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nuk mund të arrijë në përfundimin se subjekti është i papërshtatshëm. Por, duke qenë se nga analiza e trajtimit të disa çështjeve penale për të cilat ka pasur informacione konfidenciale, janë evidentuar disa problematika gjatë ushtrimit të detyrës nga subjekti, mangësitë e konstatuara janë marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes gjatë procesit të vendimmarrjes.*

➤ Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: *Në vlerësimin përfundimtar të aftësive profesionale, Komisioni vlerësoi se subjekti nuk ndodhet në kushtet e nenit 58, pika 1/b e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon marrjen e masës disiplinore – pezullim nga detyra për një periudhë 1-vjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës, pasi, sipas pikës 4 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, mangësitë e evidentuara si më sipër dhe sjelljet e papërshtatshme të subjektit nuk mund të korrigjohen përmes programit njëvjeçar të edukimit. Në përfundim të procesit, pavarësisht se mangësitë procedurale të evidentuara nuk u vlerësuan të tilla që subjekti të vlerësohet “i papërshtatshëm” sipas nenit 44/c të ligjit nr. 84/2016, në një vlerësim tërësor të rrethanave, këto mangësi, gërshetuar me rastet e cenimit të etikës nga ana e subjektit, çmohen se kanë çuar në cenimin e besimit të publikut të subjektit si pjesë e sistemit të drejtësisë dhe subjekti ndodhet në kushtet e parashikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon: “Në rast se nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e këtij ligji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka*

*cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit”, atij duhet t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.*

➤ *Konkluzioni përfundimtar: Bazuar në parimet e parashikuara në pikën 5 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, në Aneksin e Kushtetutës dhe në nenin 51 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerësoi që vendimmarrja për subjektin Saimir Bahiti të bazohet në përfundimet në vlerësimin tërësor të procedurave sipas parashikimit të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, në një vlerësim tërësor të rrethanave për të tria kriteret e vlerësimit, trajtuar hollësisht në këtë vendim, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit Saimir Bahiti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, sipas parashikimit të nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016.*

### **III. Ankimi i subjektit të rivlerësimit**

9. Kundër vendimit të Komisionit nr. 612, datë 13.01.2023, ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit Saimir Bahiti, duke kërkuar: (i) gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike; (ii) administrimin e provave të reja bashkëlidhur ankimit; (iii) konstatimin e shkeljeve të drejtave kushtetuese, si dhe ato të parashikuara nga KEDNj-ja ndaj ankuesit Saimir Bahiti; (iv) ndryshimin e vendimit nr. 612, datë 13.01.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmim në detyrë të subjektit të rivlerësimit Saimir Bahiti, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.
10. Subjekti i rivlerësimit, së bashku me ankimin, ka depozituar edhe disa akte për të cilat ka kërkuar të merren në cilësinë e provave të reja: (i) shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 03.03.2017, nga Avokati i Popullit drejtuar Kryetarit të Kuvendit; (ii) shkresë kthim përgjigje nr. {\*\*\*} prot., datë 17.07.2020, nga Avokati i Popullit drejtuar z. G. T.; (iii) vërtetim i gjendjes gjyqësore nr. {\*\*\*} prot., datë 15.03.2023, për z. P. G..
11. Në datën 14.07.2025, pas njoftimit për caktimin e seancës gjyqësore të çështjes në dhomë këshillimi, subjekti i rivlerësimit depozitoi pranë Kolegjit aktin e titulluar "Parashtrime" lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, i pashoqëruar me akte shkresore.

### **IV. Shqyrtimi i ankimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit**

#### **A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit**

##### *a) Juridiksioni i Kolegjit*

12. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit Saimir Bahiti, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

*b) Legjitimimi i ankuesit*

13. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

*c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

14. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues, në vijim, vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012, i ndryshuar”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 612, datë 13.01.2023, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.
15. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit të rivlerësimit për çelje të hetimit gjyqësor dhe marrjen e provave të reja, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
16. Sa u takon akteve shkresore që subjekti i ka bashkëlidhur ankimit, analiza mbi pranueshmërinë e tyre është kryer në kuadër të parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, të vlerësuara në harmoni me nenin 51, pika 1, shkronja “a” e të njëjtit ligj, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit nuk mund të paraqesë në ankim fakte të reja apo të kërkojë marrjen e provave të reja, përveç rastit kur provon se, pa fajin e tij, nuk ka pasur mundësi t’i paraqesë këto fakte ose të kërkojë administrimin e këtyre provave gjatë shqyrtimit të çështjes në Komision.
17. Gjithashtu, në vendimmarrjen e trupit gjykues lidhur me kërkesat e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave të reja, janë mbajtur në konsideratë edhe parashikimet e nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016.
18. Në kuadër të kësaj analize, trupi gjykues ka çmuar se aktet e depozituara së bashku me ankimin nuk përmbushin kriteret e pranueshmërisë si prova të reja në proces, referuar dispozitave ligjore të sipërcituara dhe, për rrjedhojë, nuk janë administruar në cilësinë e provës nga trupi gjykues.
19. Në vijim, trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit të rivlerësimit, kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, nëpërmjet dokumentacionit të fashikullit të administruar në Komision, nuk konstatoi shkelje procedurale të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Në referencë të dispozitës së sipërcituar, trupi gjykues çmoi gjithashtu se debati gjyqësor në seancë gjyqësore me praninë e subjektit të rivlerësimit nuk është i nevojshëm, dhe se lidhur me këtë çështje mund të arrihej në vendimmarrje nga shqyrtimi mbi bazën e dokumenteve të administruara në fashikullin e Komisionit. Për rrjedhojë, në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues vendosi të vijojë

shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

20. Gjatë seancës gjyqësore në dhomë këshillimi, të zhvilluar në datën 21.07.2025, trupi gjykues, bazuar në konstatimin se Komisioni, në kuadër të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale dhe të kontrollit e analizimit të disa procedimeve penale të hetuara nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit, krahas shkeljeve procedurale të konstatuara, për vlerësimin e peshës së tyre ishte mbështetur edhe në informacione konfidenciale të agjencive ligjzbatuese, në zbatim të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, çmoi se, për një zgjidhje objektive të çështjes, ishte e nevojshme të njihej drejtpërdrejt me informacionin e klasifikuar mbi të cilin vëzhguesi ndërkombëtar i çështjes kishte mbështetur gjetjen dhe opinionin (mendimin me shkrim) e datës 07.12.2022, informacione këto të njohura dhe të vlerësuara edhe nga Komisioni.
21. Për këtë qëllim, seanca gjyqësore e datës 21.07.2025 u ndërpre me vendim të ndërmjetëm të trupit gjykues dhe, pas kryerjes së këtij veprimi procedural, rifilloi po në të njëjtën datë.
22. Në konsideratë të qëndrimit të GjEDNj-së në çështjen *Thanza kundër Shqipërisë*<sup>1</sup> dhe bazuar në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit<sup>2</sup>, trupi gjykues, pasi u njoh në mënyrë të drejtpërdrejtë me informacione e klasifikuar pranë institucionit që e administron atë, arriti në konkluzionin se klasifikimi i informacionit është ligjërish i justifikuar dhe se ekspozimi i tij do të cenonte sigurinë e burimit të tij<sup>3</sup>.
23. Gjatë hetimit administrativ të zhvilluar në Komision, subjektit të rivlerësimit i janë kërkuar shpjegime lidhur me këto procedime penale dhe, më pas, i është kaluar barra e provës për të provuar të kundërtën e shkeljeve procedurale të konstatuara në lidhje me hetimin e tyre. Subjekti ka paraqitur shpjegime të hollësishme mbi këto konstatime të Komisionit, si dhe ka depozituar të gjitha provat që ka çmuar të nevojshme për mbrojtjen e tij.
24. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se mosnjohja e subjektit me informacionin e klasifikuar, për ekzistencën e të cilit ai kishte marrë dijeni në mënyrë të tërthortë, nuk ka cenuar të drejtën e tij të mbrojtjes në raport me shkeljet procedurale mbi të cilat Komisioni ka mbështetur konkluzionet e tij përfundimtare, në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen *Regner kundër Republikës Çeke*<sup>4</sup>.

<sup>1</sup> Shih: <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-225653>, vendimi i GjEDNj-së, çështja *Thanza kundër Shqipërisë*, paragrafët 113-123.

<sup>2</sup> Vendimet e Kolegjit nr. 7, datë 24.06.2020, nr. 14, datë 14.09.2020, si dhe nr. 31, datë 27.07.2022.

<sup>3</sup> Bazuar në parashikimet e ligjit nr. 84/2016, anëtarët e organeve të rivlerësimit kanë akses dhe mund të verifikojnë dhe studiojnë dokumente të klasifikuara, por sipas parashikimeve të kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e organeve ligjzbatuese që i disponojnë ato, pa ekspozuar burimin dhe pa përdorur këto dokumente në aktet publike. Ky parim materializohet në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në të cilin përcaktohet se informacioni nuk bëhet publik nëse ai rrezikon sigurinë e burimit [...].

<sup>4</sup> Në çështjen *Regner kundër Republikës Çeke*, GjEDNj-ja ka vlerësuar se: “[...] e drejta për zbulimin e provave përkatëse nuk është një e drejtë absolute. Në këtë çështje ka gjetur se mund të ketë interesa konkurruese, siç është siguria kombëtare ose nevoja për të mbrojtur dëshmitarët në rrezik të hakmarrjes ose të mbajë sekret metodat e policisë për hetimin e krimit, të cilat duhet të vlerësohen kundrejt të drejtave të palës në gjykim [...]. Në rastet kur provat nuk i janë vënë në dispozicion kërkuesit, për arsye të interesit publik, gjykata duhet të shqyrtojë procedurën e vendimmarrjes për të siguruar që, për aq sa është e mundur, t’u përmbahet kërkesave për të siguruar parimin e

**B. Shkaqet e ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit në Komision dhe vlerësimi i trupit gjykues**

25. Shkaqet e ankimit lidhur me aspektet procedurale të procesit të zhvilluar në Komision, subjekti i rivlerësimit i ka bazuar në pretendimet si më poshtë.
- 25.1. Në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, gjykata nuk ka qenë e pavarur dhe e paanshme duke mos garantuar procesin e rregullt ligjor.
- 25.2. Vendimi i Komisionit është marrë mbi bazën e një hetimi dhe vlerësimi administrativ të paplotë, në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin nr. 84/2016 dhe parimet themelore procedurale. Ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor, në kuptim të neneve 42 dhe 179/b, pika 2 e Kushtetutës, nenit 6 të KEDNj-së, nenit 4, pikat 5 dhe 6, nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.
- 25.3. Në shkelje të nenit 7 të KEDNj-së, është cenuar parimi i sigurisë juridike dhe vetë ligji nr. 84/2016 nuk ka parashikuar masat e nevojshme procedurale për të parandaluar zbatimin arbitrar të ligjit përkatës material.
- 25.4. Në shkelje të nenit 8 të KEDNj-së, shkarkimi i tij nga detyra është joproportional me qëllimin e ndjekur dhe përbën ndërhyrje në të drejtën e marrë në mbrojtje nga ky nen për respektimin e jetës private dhe familjare. Konkluzionet e arritura nga Komisioni nuk respektojnë parimin e proporcionalitetit, objektivitetit dhe barazisë para ligjit, parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin e dyshimit në favor të magjistratit.
26. Subjekti i rivlerësimit pretendoi shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, bazuar në analizën e kriterëve të përcaktuara nga GjEDNj-ja në çështjen *Volkov kundër Ukrainës*, pasi gjykata nuk ka qenë e pavarur dhe e paanshme dhe se procesi ndaj tij nuk është kryer nga një gjykatë e krijuar me ligj.
27. Në lidhje me këtë pretendim, trupi gjykues vlerëson se Kolegji ka një qëndrim të konsoliduar në jurisprudencën e tij, pasi në disa vendime ka analizuar dhe vlerësuar pabazueshmërinë e këtyre pretendimeve përkundrejt garancive të kuadrit kushtetues dhe ligjor të procesit të rivlerësimit, i cili ka kaluar testin e gjykimit kushtetues<sup>5</sup> edhe të GjEDNj-së<sup>6</sup>.
28. Në qëndrimin e saj, Gjkata Kushtetuese ka vlerësuar se dispozitat ligjore, mbi të cilat mbështetet krijimi i institucioneve të rivlerësimit, janë në përputhje me Kushtetutën dhe ofrojnë garanci të plota të elementeve të procesit të rregullt gjyqësor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së.
29. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se disa nga anëtarët e trupit gjykues në Komision, që shqyrtuan çështjen e tij, nuk përmbushin kriteret e përzgjedhjes së përcaktuar në ligjin nr. 84/2016. Sipas subjektit, ligji nr. 84/2016 parashikon kriterë strikte për përzgjedhjen, por nuk parashikon si do

---

*kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve dhe të ofrojë garanci të përshtatshme për të mbrojtur interesat e personit në fjalë [...]”.*

<sup>5</sup> Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017, mbështetur në Opinionin nr. CDL-AD(2016) 036 të Komisionit të Venecias: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2016\)036](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2016)036).

<sup>6</sup> Vendimi i GjEDNj-së në çështjen *Altina Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, nr.15227/19, datë 09.02.2021, paragrafët 295-300.

të verifikohen kushtet e zgjedhshmërisë së kandidatëve, si do të verifikohet integriteti i lartë moral apo profesional i tyre, si dhe nuk ka asnjë kontroll për ligjshmërinë e pasurisë së kandidatëve. Për këtë pretendim, subjekti parashtrroi se vetë Avokati i Popullit, në listën e kandidatëve që nuk plotësojnë kriteret ligjore, përcjellë në Kuvend në mars 2017, ka renditur znj. B. dhe znj. Zh., anëtare të trupës gjykuese të Komisionit që ka shqyrtuar çështjen e tij.

30. Subjekti pretendon se Kolegji ka pranuar në jurisprudencën e tij se nuk ka juridiksion t'u japë përgjigje subjekteve të rivlerësimit nëse janë gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj si pjesë e rëndësishme e procesit të rregullt ligjor, marrë në mbrojtje nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së dhe, në këto kushte, ai nuk ka një mundësi për të sfiduar përmbajtjen e trupit gjykues të Komisionit. Ky qëndrim i mbajtur deri tani nga Kolegji, është në kundërshtim me Aneksin e Kushtetutës dhe vendimet e GjEDNj-së në çështjet *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, *Cani kundër Shqipërisë*, si dhe *Sevdari kundër Shqipërisë* dhe, për këtë arsye, Kolegji duhet të ndryshojë praktikën e tij, duke shqyrtuar pretendimet e ankuesit në lidhje me mospërmbushjen e kriterëve ligjore nga anëtarët e institucioneve të rivlerësimit.

30.1 Lidhur me këto pretendime të ankuesit, trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin e mbajtur nga Kolegji<sup>7</sup>, në të njëjtën linjë me GjEDNj-në<sup>8</sup>, duke i analizuar dhe vlerësuar këto pretendime në disa këndvështrime, nën dritën e garancive procedurale që gëzon subjekti i rivlerësimit, sipas legjislacionit shqiptar dhe jurisprudencës së GjEDNj-së, ndër të tjera, çështjet *Astradsson kundër Islandës* dhe *Cani kundër Shqipërisë*. Konkretisht, në rastin e trajtimit të pretendimeve analoge, Kolegji ka vlerësuar si vijon: [...] *trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë natyrën e jashtëzakonshme të procesit të rivlerësimit dhe qëllimin e legjislatorit që, në kontekstin e një vlerësimi kalimtar, përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit t'i nënshtrohej disa procedurave të mirëpërcaktuara. Mbi bazën e këtyre parimeve, edhe përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve pasqyroi vullnetin politik të përfaqësuar të shoqërisë shqiptare. Në zbatim të këtij qëllimi, ligji nr. 84/2016, mbi bazën e të cilit është kryer përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve, përcakton në detaj dhe çdo hap që do të duhet t'i paraprinte emërimit fundor të tyre. Me fjalë të tjera, qëllimi i legjislatorit, për të krijuar një infrastrukturë të aftë për të kryer procesin, është shoqëruar me garanci që përjashtojnë kontestimin e mandateve të anëtarëve të institucioneve që, nëse do t'i lihej rastësisë, do të sfidonte qëllimin dhe natyrën e jashtëzakonshme, kalimtare dhe me afat të përcaktuar të procesit të rivlerësimit. Së fundmi, në këtë analizë të gjithanshme të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues mban në konsideratë balancën që duhet të mbahet në funksion të sigurisë ligjore dhe kohës që ka kaluar nga momenti i krijimit të institucioneve të rivlerësimit, përfshirë edhe Komisionin. Nën dritën e efektit negativ që do të kishte kontestimi pa afat mbi bazën e pretendimeve për gjykatë të krijuar me ligj, sipas testit të vendosur nga GjEDNj-ja<sup>9</sup>, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë peshën me të cilën shoqërohet siguria ligjore me kalimin e kohës kundrejt të drejtave individuale të subjektit të rivlerësimit. Këto të drejta, në rrethanat konkrete, pa përsëritur sa është shtjelluar*

<sup>7</sup> Shih vendimet e Kolegjit (JR) nr. 43, datë 15.11.2022, si dhe (JR) nr. 3, datë 06.02.2023.

<sup>8</sup> Shih vendimet e GjEDNj-së, çështja *Altina Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, paragrafët 66-73; çështja *Besnik Cani kundër Shqipërisë*, paragrafët 66-73, çështja *Sevdari kundër Shqipërisë*, paragrafi 109; çështja *Admir Thanza kundër Shqipërisë*, paragrafët 83- 84.

<sup>9</sup> <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-206582>, paragrafi 221.

*më sipër, konsiderohen të adresuara nga kontrolli i gjithanshëm i vendimit të Komisionit, kryer në Kolegj [...].*

31. Subjekti i rivlerësimit pretendon se fakti që vetë Kushtetuta, e cila parashikon shprehimisht se parimi i pavarësisë dhe paanësisë nuk zbatohet plotësisht për anëtarët e Komisionit dhe Kolegjit, është një parashikim i paprecedent.

31.1 Lidhur me këtë pretendim të ankuesit, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë se normat kushtetuese dhe ligjore që garantojnë pavarësinë e organeve të rivlerësimit, janë vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, e cila ka arsyetuar se: [...] *Gjykata, duke bërë një interpretim sistematik të dispozitave të ligjit të kundërshtuar, nga konteksti i tyre, si dhe nisur nga kuptimi i përgjithshëm i këtij ligji, vlerëson se qëllimi i tyre është përcaktimi i rregullave që do të ndiqen gjatë procesit të rivlerësimit nga organet kushtetuese të pavarura, të cilat janë të vetmet organe që kanë kompetencën për të realizuar kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, si dhe kriteret dhe mënyra e realizimit të këtij procesi. [...].* Gjithashtu, edhe GjEDNj-ja ka mbajtur qëndrim, duke vlerësuar të pabazuara pretendimet lidhur me pavarësinë e organeve të rivlerësimit, për sa kohë që subjektet e rivlerësimit që i kanë ngritur ato, nuk kanë kontestuar paanësinë subjektive të anëtarëve të organeve të rivlerësimit<sup>10</sup>. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit, lidhur me kuadrin kushtetues dhe ligjor të rivlerësimit kalimtar, proces me natyrë të jashtëzakonshme me qëllim rikthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, vlerësohen të pabazuara.

32. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, nuk është dëgjuar drejtësisht, në kundërshtim me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve, pasi Komisioni nuk i ka bërë me dije asnjë gjetje e cila të referon te masa disiplinore e parashikuar nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Lidhur me këtë pretendim, subjekti parashtroi se Komisioni ka detyrimin ligjor të kalojë barrën e provës për çdo gjetje që, sipas vlerësimit të tij, përbën mospërmbushje të detyrimit ligjor nga ana e subjektit dhe ka si sanksion marrjen e një mase administrative. Komisioni duhet t'i komunikojë drejtpërdrejt subjektit nëse elementet e konstatuara mund të çojnë drejt prezumimit të vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit apo ndonjë mase tjetër në garantim të së drejtës së tij për të paraqitur prova dhe argumente, si dhe për t'u dëgjuar e mbrojtur në mënyrë efektive ndaj akuzave që prezumojnë shkarkimin e tij.
33. Në lidhje me këtë pretendim, trupi gjykues konstaton se, nga analizimi i raportit të rezultateve të hetimit administrativ të njoftuar subjektit të rivlerësimit nga Komisioni, rezulton se në të janë pasqyruar të gjitha provat e administruara, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorëve të drejtuar nga Komisioni, si dhe janë evidentuar qartë konstatimet për të cilat, në bazë të parashikimeve të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i është kaluar barra e provës lidhur me të gjitha gjetjet e konstatuara nga kontrolli i të tria kritereve të rivlerësimit.
34. Dispozitat e kuadrit ligjor të rivlerësimit nuk parashikojnë detyrimin që Komisioni, në këtë akt procedural, të shprehet lidhur me prezumimin e masës disiplinore, për sa kohë në këtë fazë të procesit konstatimet nuk kanë karakter përfundimtar dhe subjekti i rivlerësimit gëzon të drejtën e mbrojtjes nëpërmjet paraqitjes së parashtrimeve me shkrim, depozitimit të provave dhe

---

<sup>10</sup> *Shih vendimin e GjEDNj-së, çështja Xhoxhaj kundër Shqipërisë, paragrafin 296 e vijues.*

dëgjimit në seancë dëgjimore, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit vlerësohet i pabazuar.

35. Subjekti i rivlerësimit pretendon se rregullat e përcaktuara për procesin e rivlerësimit, si dhe mënyra e zbatimit të tyre në rastin konkret, janë të padrejta dhe në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike, pasi, sipas tij, Komisioni ka arritur në konkluzione të ndryshme nga ato të dhëna në procese të tjera ndaj subjekteve të tjera të rivlerësimit për çështje të ngjashme me rastin e tij. Sipas subjektit, ky fakt tregon se Komisioni ka mbajtur një qëndrim të njëanshëm dhe se rezultati i hetimit administrativ ka qenë subjektiv dhe i paracaktuar.
36. Subjekti pretendon gjithashtu se ligji nr. 84/2016 nuk parashikon masa të mjaftueshme procedurale për të parandaluar zbatimin arbitrar të ligjit material, duke cenuar në këtë mënyrë parimin e sigurisë juridike.
37. Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, në vlerësimin e tij, u referohet vendimeve të Komisionit në të cilat është mbajtur një qëndrim i ndryshëm për situata të ngjashme me ato të subjektit, duke mos u bërë shkak për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra<sup>11</sup>. Për këtë pretendim, si dhe për pretendimin tjetër të subjektit për standarde të ndryshme të Komisionit, referuar jurisprudencës<sup>12</sup> së Kolegjit, trupi gjykues vlerëson se ato nuk mund të përbëjnë *apriori* shkak për të konsideruar të padrejtë vendimin e Komisionit objekt kontrolli, pasi çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e rrethanave faktike të provuara nga gjykimi dhe në zbatimin e duhur të ligjit mbi situatën konkrete faktike.
38. Subjekti i rivlerësimit pretendon se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra përbën një ndërhyrje në të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, të parashikuar nga neni 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pasi, si pasojë e kësaj mase disiplinore, ai ka humbur mundësinë për të ushtruar një profesion në përputhje me kualifikimin dhe eksperiencën e tij profesionale.
39. Sipas subjektit, për shkak të kësaj mase, ai nuk mund të ushtrojë gjatë gjithë jetës funksionin e gjyqtarit apo të prokurorit dhe, po ashtu, në bazë të parashikimeve të nenit 21 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nuk mund të aplikojë për një detyrë apo funksion në administratën publike.
40. Subjekti pretendon gjithashtu se, për shkak të parashikimeve të neneve 5 dhe 23 të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar, ai nuk mund të ushtrojë profesionin e noterit apo të ekspertit të pavarur. Po kështu, për shkak të parashikimeve të nenit 13 të ligjit nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit”, ai nuk mund të ushtrojë profesionin e avokatit, pasi kjo dispozitë parashikon se gjyqtarët dhe prokurorët e shkarkuar si rezultat i procesit të rivlerësimit nuk mund të marrin titullin e avokatit, madje edhe ata që e kanë fituar më parë, mund ta humbasin atë në një moment të mëvonshëm.

---

<sup>11</sup> Subjekti i rivlerësimit i referohet vendimit të Kolegjit nr. 42/2022.

<sup>12</sup> Shih vendimet e Kolegjit nr. 33/2022, nr. 35/2022 etj.

41. Në lidhje me këto pretendime të subjektit se, me masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, ka humbur të gjitha mundësitë për punësim që përkojnë me kualifikimin dhe eksperiencën e tij profesionale, pasi nuk mund të ushtrojë gjithë jetën profesionin e gjyqtarit apo prokurorit, nuk mund të aplikojë për një pozicion pune në administratë publike, të jetë noter apo ekspert i pavarur apo të marrë titullin e avokatit, trupi gjykues vlerëson se pretendime të tilla janë trajtuar prej Kolegjit në jurisprudencën e tij<sup>13</sup>, në të njëjtën linjë me qëndrimin e mbajtur nga GjEDNj-ja në çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*<sup>14</sup>, duke vlerësuar se, për sa shkarkimi nga detyra ka ardhur si pasojë e shkeljeve të konstatuara gjatë procesit të rivlerësimit, nuk ka shkelje të nenit 8 të KEDNj-së.
42. Subjekti pretendon se është cenuar e drejta e parashikuar nga neni 8 i KEDNj-së pasi shkaqet e shkarkimit nuk bazohen në ligj dhe në provat e administruara, si dhe nuk janë në përputhje me parimin e proporcionalitetit, objektivitetit dhe barazisë para ligjit. Sipas subjektit, GjEDNj-ja në jurisprudencën e saj, në çështjet *Xhoxhaj dhe Sevdari kundër Shqipërisë*, ka vendosur standarde sa i përket respektimit të parimit proporcionalitetit dhe se institucionet e rivlerësimit duhet të udhëhiqen nga parimi i barazisë para ligjit, kushtetutshmërisë, ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe të parimeve të tjera të cilat garantojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Arsyet e dhëna nga Komisioni për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, nuk janë relevante dhe as të mjaftueshme për të justifikuar një masë të tillë të rëndë dhe me pasoja të rënda në jetën profesionale të tij, siç është shkarkimi nga detyra.
43. Në lidhje me këtë shkak ankimi, sikurse është elaboruar në jurisprudencën e Kolegjit dhe tashmë është konfirmuar edhe nga kontrolli i ushtruar nga GjEDNj-ja në çështjen udhëheqëse të rivlerësimit, *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, masa disiplinore e shkarkimit, e parashikuar nga ligji nr. 84/2016, nuk rezulton disproporcionale dhe as në kundërshtim me parimet e nenit 8 të KEDNj-së<sup>15</sup>. Në rastin konkret, masa disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit është marrë bazuar në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi Komisioni ka çmuar se, në vlerësimin tërësor të rrethanave lidhur me të tria kriteret e trajtuara hollësisht në vendim, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë.
44. Për sa më sipër, vlerësohet se, në përputhje me qëndrimin e mbajtur nga Kolegji në çështje të tjera<sup>16</sup>, proporcionaliteti është pjesë e tërësisë së parimeve nga të cilat udhëhiqen institucionet e rivlerësimit dhe nuk mund të gjejë zbatim si parim i veçantë dhe i vetëm i këtij procesi. Ky parim zbatohet, sipas rastit, duke vlerësuar situatën faktike konkrete që rezulton nga provat e

---

<sup>13</sup> Shih vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 23, datë 28.06.2022.

<sup>14</sup> Shih vendimin e GjEDNj-së, çështja *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, ku gjykata ka mbajtur qëndrim: “[...] Ndalimi i përjetshëm i vendosur ndaj kërkueses dhe individëve të tjerë të shkarkuar, për shkak të shkeljeve të rënda etike, nuk është në kundërshtim ose në raport të zhdrejtë me objektivin legjitim të ndjekur nga Shteti për të siguruar integritetin e detyrës gjyqësore dhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë (shih, *mutatis mutandis*, Naidin kundër Rumanisë).

<sup>15</sup> Shih paragrafët 402 dhe 403 të vendimit të GjEDNj-së në çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*.

<sup>16</sup> Shih vendimet e Kolegjit nr. 2/2020, datë 27.02.2020; nr. 20/2020, datë 08.09.2020 dhe nr. 36/2020, datë 16.12.2020.

administruara, si dhe duke mbajtur parasysh standardet objektive të vendosura nga jurisprudenca e Kolegjit<sup>17</sup>.

45. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka vlerësuar negativisht fakte, rrethana apo gjetje të cilat nuk i janë bërë me dije gjatë procesit administrativ, siç është fakti i konstatuar nga Komisioni se subjekti ka marrë hua nga një shoqëri me precedent penal, ndërkohë që ky konstatim nuk i është njoftuar me rezultatet paraprake të hetimit.
46. Në lidhje me këtë pretendim, referuar vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues vëren se, në paragrafin 141 të vendimit, Komisioni ka arsyetuar se: [...] *Për më tepër, shoqëria “{\*\*\*}” ShPK është një shoqëri me precedentë penalë për shkak se në Prokurorinë e Shkodrës janë trajtuar dy procedime penale në ngarkim të saj, përkatësisht në vitin 2015 dhe 2019, pavarësisht se në një rast subjekti ka hequr dorë dhe në rastin tjetër çështja është pushuar nga një prokuror tjetër.* Në rezultatet e hetimit, Komisioni i ka bërë me dije subjektit se për këtë shoqëri janë regjistruar dy procedime penale në vitet 2015 dhe 2019 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, për të cilat subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime konkrete lidhur me mospërfshirjen e tij në këto dy procedime.
47. Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar gjithashtu se Komisioni nuk i ka kaluar barrë prove në lidhje me gjetjet në kuadër të kontrollit të figurës. Në vlerësim të këtij pretendimi, trupi gjykues vëren se, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit i është kërkuar të japë sqarime në lidhje me raportin e DSIK-së dhe, në parashtrimet e tij, subjekti ka deklaruar se nuk gjendet asnjë shpjegim mbi arsyet që DSIK-ja ka ndryshuar konkluzionin nga i përshtatshëm në i papërshtatshëm, dhe se ai nuk është njohur me dokumentet ku mbështetet ky konkluzion. Po ashtu, subjekti ka deklaruar se raporti i dytë i DSIK-së është joserioz, i pabazuar dhe jo i drejtë, për më tepër që raporti i dytë u referohet të “dhënave” për kohën përpara se të dilte raporti i parë i të njëjtit institucion. Subjekti ka deklaruar se ka plotësuar në mënyrë të saktë formularin e kontrollit të figurës, nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme, si dhe nuk është përpjekur të fshehtë kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar e, në këto kushte, ai i plotëson të gjitha kriteret e parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 34-39 të ligjit nr. 84/2016 për t’u konsideruar i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.
48. Në konkluzion të sa analizuar më sipër, lidhur me shkaqet e ankimit të ngritura nga subjekti i rivlerësimit për shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor nga Komisioni, trupi gjykues vlerëson se ato janë të pabazuara në fakte dhe në ligj.

### ***C. Shkaqet e ankimit lidhur me kriteret e rivlerësimit dhe vlerësimi i trupit gjykues***

*Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale*

49. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar vlerësimin e Komisionit se: *subjekti nuk ndodhet në kushtet e nenit 58, pika 1/b e ligjit nr.*

---

<sup>17</sup> Si: (i) masa disiplinore e shkarkimit të jetë në raport të drejtë me shkeljen e kryer nga subjekti i rivlerësimit; (ii) gjykimi duhet bërë në tërësinë e procesit të tij të rivlerësimit dhe që rëndësia e shkeljes të jetë e tillë që të lejojë ose jo zbatimin e këtij parimi; (iii) dhënia e një mase disiplinore, e cila nxjerr subjektet jashtë sistemit të drejtësisë, bazuar vetëm në standarde objektive, duke u siguruar që masa e dhënë të jetë e nevojshme për të përmbushur qëllimin e ligjit, si dhe duke vlerësuar që masa e dhënë të jetë në proporcion me shkeljet e konstatuara.

84/2016, i cili parashikon marrjen e masës disiplinore – pezullim nga detyra për një periudhë 1-vjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës, pasi, sipas pikës 4 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, mangësitë e evidentuara si më sipër dhe sjelljet e papërshtatshme të subjektit nuk mund të korrigjohen përmes programit njëvjeçar të edukimit. Në përfundim të procesit, pavarësisht se mangësitë procedurale të evidentuara nuk u vlerësuan të tilla që subjekti të vlerësohet “i papërshtatshëm” sipas nenit 44/c të ligjit nr. 84/2016, në një vlerësim tërësor të rrethanave, këto mangësi, gërshetuar me rastet e cenimit të etikës nga ana e subjektit, çmohen se kanë çuar në cenimin e besimit të publikut të subjektit si pjesë e sistemit të drejtësisë dhe subjekti ndodhet në kushtet e parashikimit të nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon: “Në rast se nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e këtij ligji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemit të drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit”, atij duhet t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

50. Komisioni e ka mbështetur këtë vlerësim në analizën e veprimtarisë së ushtruar nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit, në disa procedime penale.
51. Subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të përgjithshme, kundërshtimin e tij ndaj vlerësimit të Komisionit e ka bazuar në pretendimet se:

51.1. Në procesin e rivlerësimit, vlerësimi i aftësive profesionale është veçanërisht i ndjeshëm, në dritën e nevojës për të shmangur dëmtimin, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në ushtrimin e pavarur të diskrecionit gjyqësor. Sipas tij, mangësitë profesionale mund të çojnë në shkarkim vetëm kur nuk mund të përmirësohen nëpërmjet programit njëvjeçar të trajnimit, ndërsa modalitetet dhe kufijtë e vlerësimit të aftësive profesionale janë vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese, Komisioni i Venecias<sup>18</sup>, gjithashtu edhe nga Kolegji, i cili ka unifikuar qëndrimin e tij në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale<sup>19</sup>. Treguesit kryesorë për vlerësimin e aftësive profesionale parashikohen në ligjin nr. 96/2016, ku ligji nr. 84/2016 referon.

51.2. Referuar në parashikimet ligjore të ligjit nr. 96/2016, subjekti pretendon se procesi i rivlerësimit kalimtar është një proces disiplinor ku duhet të zbatohen dhe parimet e procedimit disiplinor, të parashikuara në nenin 100 të këtij ligji, si: parimi i prezumimit të pafajësisë dhe parimi i dyshimit në favor të magjistratit, si dhe duhet të merren në konsideratë edhe faktorë të tjerë, si: shkalla e pafajësisë, shpejtësia e kryerjes së veprimit ose mosveprimit apo sjelljes, përvoja dhe pozicioni i magjistratit në sistem, dëmtimi/mundësia e shkaktimit të dëmtimit ose shkalla e pasojave që kanë ardhur nga veprimi ose mosveprimi, si dhe çdo situatë që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor ose të prokurorisë. Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit mbi themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e magjistratit që vlerësohet.

<sup>18</sup> Subjekti i rivlerësimit referon vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe opinionin CDL-AD (2016) 036 të Komisionit të Venecias, sipas të cilëve vlerësimi negativ në kuadër të aftësive profesionale bëhet vetëm në ato raste të gabimeve thelbësore dhe/ose serioze, kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mangësi të aftësive profesionale.

<sup>19</sup> Subjekti i referohet vendimit të Kolegjit nr. 21, datë 13.09.2019, për subjektin e rivlerësimit G. M..

51.3. Konkluzionet e Komisionit, sipas subjektit, në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale, nuk qëndrojnë dhe nuk konstatohen gabime që tejkalojnë ato që mund të ndodhin në rrethana normale nga një magjistrat mesatar, apo ndonjë pasojë e ardhur për palët, pavlefshmëri, papërdorshmëri, kufizim i lirive apo ndonjë pasojë tjetër e kësaj natyre. Komisioni ka marrë në shqyrtim veprimtarinë e tij disavjeçare gjatë së cilës ka shqyrtuar me mijëra çështje penale dhe, për të gjithë periudhën, ka konstatuar gjetje vetëm në pak raste, të parëndësishme, në të cilat nuk konstatohet ndonjë shkelje e rëndë.

51.4. Komisioni ka tejkualuar periudhën e rivlerësimit, parashikuar në nenin 41, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, e cila duhet të përfshijë për efekt të këtij ligji vetëm periudhën 3 tetor 2013 – 8 tetor 2016 pasi veprimtaria e magjistratëve pas periudhës tetor 2016 i nënshtrohet juridiksionit të zakonshëm të kontrollit nga organet e tjera të miratuara nga reforma në drejtësi. Organet e rivlerësimit nuk kanë kompetencë të verifikojnë figurën, profesionalizmin dhe mënyrën e krijimit të pasurive për periudhën pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016. Bazuar në nenin E të Aneksit të Kushtetutës, vlerësimi i aftësive profesionale nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim, ndërkohë që disa nga çështjet të cilat janë bërë shkak për marrjen e masës disiplinore, kanë qenë në shqyrtim pas datës së fundit të parashikuar për periudhën e rivlerësimit dhe një prej tyre është ende në shqyrtim.

51.5. Në vlerësimin e aftësive profesionale, Komisioni duhet të merrte në konsideratë qëndrimin e KPA-së në vendimin nr. 20, datë 08.09.2020, ku theksohet se është e pamundur që në kuadër të vlerësimit të figurës të zbatohen standardet e kontrollit të aftësive profesionale, pasi burimet mbi të cilat merren informacionet për kontrollin e këtyre kritereve të rivlerësimit, janë të ndryshme, gjithashtu i ndryshëm është edhe objekti i kontrollit.

52. Në vijim të ankimit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar shkaqet për të cilat kundërshton mangësitë e konstatuara dhe konkluzionet e arritura nga Komisioni në vendim, lidhur me gjashtë procedime penale të hetuara prej tij, të trajtuara si vijojnë.

➤ *Lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2014<sup>20</sup> të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës:*

53. Lidhur me këtë procedim penal, Komisioni ka vlerësuar se sqarimet e dhëna nga subjekti në lidhje me mosadministrimin në dosje të procesverbalit për kthimin e provave materiale, vlerësohen jobindëse, pasi subjekti nuk është shprehur në lidhje me mungesën e administrimit në dosje të procesverbalit për kthimin e provës materiale, duke u shprehur vetëm në lidhje me faktin që kjo nuk e kushtëzon hetimin dhe mund të administrohet në çdo kohë. Procesverbali për kthimin e provës materiale duhet të jetë pjesë e dosjes penale dhe mungesa e tij konsiderohet si një mangësi në drejtim të administrimit të dokumenteve në dosjen penale.

54. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se, pavarësisht se nuk bie dakord me konkluzionin e Komisionit në lidhje me këtë procedim, është e qartë që në këtë rast, gjetja është tërësisht e parëndësishme dhe nuk mund të ketë asnjë peshë në procesin e rivlerësimit. Më tej, subjekti ka sqaruar se kthimi i provës materiale nuk e kushtëzon pushimin e çështjes dhe se kthimi i sendit,

---

<sup>20</sup> Dosja nr. 3, si një nga pesë dosjet e përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

kur ai nuk shërben më si provë materiale për hetimin/gjykimin, mund të bëhet në çdo kohë, qoftë edhe me vendim përfundimtar sipas nenit 109 të Kodit të Procedurës Penale, ndërsa procesverbali që dokumenton kthimin e sendit mund të administrohet në çdo kohë në dosjen hetimore. Subjekti po ashtu pretendon se ndaj këtij vendimi nuk është ushtruar ankim nga asnjë palë si për përfundimin e hetimit, ashtu edhe për kthimin e pasaportës biometrike dhe lejes së qëndrimit italiane pronarit të saj të ligjshëm.

55. Pas shqyrtimit të akteve të fashikullit të Komisionit lidhur me dosjen e procedimit penal, në raport me arsyetimin e vendimit dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstaton si më poshtë.
56. Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në datën 5.6.2014, është regjistruar procedimi penal nr. {\*\*\*/2014 për veprën penale të “Dhënies së ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit”, parashikuar nga neni 298/1 i Kodit Penal. Në datën 27.06.2014, drejtuesi i prokurorisë, z. B. H., ka vendosur zëvendësimin e prokurorit duke ngarkuar për vazhdimin e hetimeve të kësaj çështjeje penale subjektin e rivlerësimit. Më datë 18.7.2014, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka nxjerrë “Vendim për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*/2014”, si dhe ka urdhëruar kthimin e pasaportës biometrike dhe lejes së qëndrimit italiane shtetasit A. R., veprim të cilin ia ka deleguar Oficerit të Policisë Gjyqësore D. H.. Referuar akteve në dosjen e procedimit penal, nuk rezulton të jetë administruar në dosje procesverbali për kthimin e pasaportës biometrike dhe lejes së qëndrimit italiane, të sekuestruara më parë sipas procesverbalit të datës 04.06.2014.
57. Subjekti ka pretenduar se procedimi penal është pushuar me vendimin e pushimit të datës 18.7.2014 dhe, në lidhje me këtë procedim penal, nuk ka shënime në regjistër për shfuqizim vendimi apo vendim për rifillimin e çështjes. Për të mbështetur pretendimet e tij, subjekti ka paraqitur shkresën “Kthim përgjigjeje” nr. {\*\*\*/2022} prot., datë 23.12.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe shkresën “Kthim përgjigjeje” nr. {\*\*\*/2022} prot., datë 28.12.2022, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.
58. Referuar sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se Komisioni e ka konstatuar drejt situatën faktike lidhur me gjendjen e akteve në dosjen e këtij procedimi penal. Po ashtu, vërehet se subjekti i rivlerësimit, si gjatë hetimit administrativ, ashtu edhe në ankim, nuk ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me mungesën e procesverbalit për kthimin e provës materiale, duke u mjaftuar vetëm me pretendimin se ky procesverbal mund të administrohet në çdo kohë.
59. Në vlerësimin e trupit gjykues, mungesa e procesverbalit për kthimin e provës materiale në dokumentacionin e dosjes, përbën tregues të mangësive në administrimin e rregullt të dosjeve dhe fashikujve të procedimit penal, pasi është detyrë e prokurorit të garantojë që dosja ose praktika të mos ketë mungesa aktesh dhe që dokumentacioni i përfshirë në dosjen penale të jetë i plotë dhe i rregullt.
60. Pretendimi i subjektit se ky lloj procesverbalit mund të mbahet dhe administrohet në çdo kohë, vlerësohet i pabazuar, pasi, referuar përmbajtjes së tij, rezulton se ai kërkon, përveç nënshkrimit të oficerit të policisë gjyqësore të autorizuar për kryerjen e veprimit dhe mbajtjen e procesverbalit përkatës, edhe nënshkrimin e personit marrës në dorëzim, në këtë rast shtetasit A. R.. Një veprim

i tillë do të ishte praktikisht i pamundur të realizohej në një moment të mëvonshëm, sipas pretendimit të subjektit, duke pasur parasysh se procedimi penal është pushuar, ndërsa shtetasi A. R. i cili jetonte jashtë Shqipërisë, ka marrë dokumentet e identifikimit dhe nuk ka më asnjë detyrim për t'u paraqitur për kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale.

61. Sa më sipër, ndonëse e gjen të bazuar konstatimin e Komisionit në lidhje me këtë procedim penal, trupi gjykues vlerëson se ky fakt nuk mund të shërbejë si bazë për dhënien ndaj subjektit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

➤ *Lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*/} / 2015<sup>21</sup> të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër:*

62. Lidhur me këtë procedim penal, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti duhet të ishte treguar i kujdesshëm në hartimin e akteve procedurale sipas rregullave mbi nënshkrimin dhe datën e tyre, të parashikuara në nenet 99 dhe 100 të Kodit të Procedurës Penale. Referuar akteve të dosjes penale, Komisioni ka vlerësuar se në dosje nuk ka pse të administrohen formalisht dokumente tip që nuk kanë përmbajtje dhe se subjekti nuk ka dhënë sqarime në lidhje me mungesën e datës apo mungesën e emrit dhe të mbiemrit të të pandehurit në aktin “Për njohjen e të pandehurit me aktet” apo vendimin “Për marrjen e personit si të pandehur”.

63. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se gjykatat që kanë marrë në shqyrtim procedimin penal nr. {\*\*\*/}/2015, nuk kanë konstatuar asnjë pasaktësi në aktet e përcjella për gjykim. Sipas tij, në rastin konkret, nuk rezulton të jetë shkelur asnjë rregull dhe nuk ka asnjë pasojë të ardhur. Mungesa e datës në një procesverbal është gabim material pa asnjë pasojë dhe data e këtij akti rezulton nga aktet e tjera të administruara në fashikull. Sipas subjektit, evidentimi i fakteve të kësaj natyre të parëndësishme si shkaqe për dhënien e masës disiplinore, tregon paracaktim të rezultatit ndaj ankuesit dhe dhënien e masës disiplinore më të rëndë, mbështetur në gjetje të paqena.

64. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit lidhur me dosjen e këtij procedimi penal në raport me arsyetimin e vendimit objekt kontrolli dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me procedurat e ndjekura prej tij si prokuror i çështjes, konstatoi si më poshtë.

65. Bazuar në materialin referues të oficerit të policisë gjyqësore, më datë 15.07.2015, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal, si dhe ka regjistruar emrin e shtetasit Gj. L. në *cilësinë e personit që i atribuohet vepra penale*, për kryerjen e veprës penale të “Vjedhjes së energjisë elektrike apo impulseve telefonike”, parashikuar nga neni 137/2 i Kodit Penal. Ky person është hetuar fillimisht nën masën e sigurimit “arrest në burg” me afat dhe më pas me masë sigurimi “arrest shtëpie”. Më datë 22.07.2015, subjekti i rivlerësimit ka marrë vendim për marrjen si të pandehur dhe njoftimin e akuzës shtetasit Gj. L., për veprën penale të “Vjedhjes së energjisë elektrike apo impulseve telefonike”, parashikuar nga neni 137/2 i Kodit Penal. Më datë 03.08.2015, subjekti i rivlerësimit ka marrë

---

<sup>21</sup> Dosja nr. 4, si një nga pesë dosjet e përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

vendimin për dërgimin e çështjes për gjykim duke proceduar në vijim me kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, viti 2015, paraqitur pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.

66. KLP-ja, në raportin për vlerësimin e atësive profesionale, ka konstatuar se nga ana e subjektit të rivlerësimit Saimir Bahiti, nuk është treguar kujdes në përpilimin e procesverbalit të pyetjes së të pandehurit, si dhe atë të njohjes me aktet, ku mungojnë data, pyetjet e përgjigjet e të pandehurit, si dhe emri i avokatit mbrojtës.
67. Në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kërkuar subjektit të japë sqarime në lidhje me konstatimin se nuk është treguar kujdes në përpilimin e procesverbalit të pyetjes së të pandehurit, si dhe atë të njohjes me aktet, ku mungojnë data, pyetjet dhe përgjigjet e të pandehurit, si dhe emri i avokatit mbrojtës, duke kërkuar nga subjekti paraqitjen e vendimit të gjykatës mbi kërkesën për gjykim të kësaj çështjeje.
68. Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se akti i pyetjes së të pandehurit në dosje nuk ka ndonjë vlerë juridike, pasi një veprim i tillë nuk është kryer. Sipas tij, i pandehuri nuk është pyetur sepse ai ka përfitur nga e drejta e tij për të mos dhënë deklarime dhe se formati i pyetjes së të pandehurit, gjetur në dosjen hetimore, konsiston në procesverbal tip. Ndërsa, për sa i përket konstatimit se mungon emri i avokatit në vendimin për dërgimin e çështjes në gjyq, subjekti ka sqaruar se në këtë vendim, është nënshkrimi i të pandehurit, ndërsa në aktin për marrjen e tij si të pandehur, ka vënë vetëm nënshkrimin ndërsa i pandehuri ka hequr dorë nga mbrojtja e të drejtave të tij me avokat. Më tej, subjekti ka shpjeguar se me vendimin nr. {\*\*\*} ({\*\*\*}), datë 9.11.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, i pandehuri është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “Vjedhje e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”. Ky vendim është ankimuar nga i pandehuri Gj. L. në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila ka vendosur mospranimin e ankimit<sup>22</sup>.
69. Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues konstaton se gjetjet e Komisionit, të cilat kanë të bëjnë me: (i) administrimin nga ana e subjektit të dokumenteve tip dhe pa përmbajtje në aktet e dosjes së procedimit penal nr. {\*\*\*}/2015; si dhe (ii) mungesën e emrit të të pandehurit dhe datës në aktin “Për njohjen e të pandehurit me aktet”, si edhe në vendimin “Për marrjen si person të pandehur”, janë të drejta dhe të bazuara. Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit penal, trupi gjykues vëren se ato janë mbajtur dhe përpiluar në mënyrë të shkujdesur, fakt që tregon për pakujdesinë e subjektit në hartimin dhe nënshkrimin e akteve të procedimit penal, në kundërshtim me parashikimet e neneve 99 dhe 100 të Kodit të Procedurës Penale.
70. Pavarësisht sa më sipër, ndonëse e gjen të bazuar konstatimin e Komisionit në lidhje me këtë procedim penal, trupi gjykues vlerëson se ky fakt nuk ka ndikuar në garantimin e të drejtave të të proceduarit dhe nuk mund të shërbejë si bazë për dhënien ndaj subjektit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

---

<sup>22</sup> Subjekti ka paraqitur shkresën me nr. {\*\*\*} prot., datë 20.12.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

➤ *Lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2018<sup>23</sup> të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë:*

71. Lidhur më këtë procedim penal, Komisioni ka vlerësuar se, nga analiza e akteve të dosjes së procedimit penal dhe sqarimet e dhëna nga subjekti, vërehet se çështja ka qenë në hetim nga subjekti i rivlerësimit për një periudhë disamujore, nga muaji nëntor 2018 - qershor 2020 dhe, pas largimit të tij në një tjetër prokurori, hetimet kanë vijuar nga një tjetër prokurore, e cila i ka dhënë dhe zgjidhjen përfundimtare çështjes. Gjatë hetimit të çështjes, janë paraqitur gjithsej 5 kërkesa nga shtetasja T. M., nga të cilat vetëm kërkesa e datës 19.3.2020, ka qenë brenda periudhës që subjekti e ka pasur çështjen nën trajtim, për të cilën nuk evidentohet të jetë dhënë përgjigje sipas rregullave të parashikuara në nenin 110, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale.
72. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se dosja është jashtë periudhës së rivlerësimit kalimtar dhe konkluzioni i Komisionit është i pabazuar. Komisioni nuk ka marrë parasysh faktin se ky procedim penal është hetuar nga subjekti për një periudhë disamujore (nëntor 2018 deri shtator 2019), duke i adresuar subjektit një shkelje që nuk i përket dhe i rëndon pozitën. Po ashtu, subjekti pretendon se është caktuar përkohësisht si prokuror i çështjes në tetor të vitit 2018 deri më 27.09.2019 kur, sipas urdhrin nr. {\*\*\*}, datë 27.09.2019 të KLP-së<sup>24</sup>, është rikthyer në pozicionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër dhe, në këto kushte, nuk ka pasur mundësi ligjore dhe objektive që t'u kthejë përgjigje kërkesave në lidhje me një procedim penal që nuk e ka pasur më nën hetim.
73. Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues konstaton se Komisioni nuk i ka renditur gjetjet në lidhje me këtë procedim penal ndër shkaqet të cilat kanë ndikuar në vlerësimin përfundimtar për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra<sup>25</sup>. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se, për sa kohë vlerësimi i Komisionit në lidhje me këtë procedim penal, nuk ka ndikuar në dhënien e masës disiplinore në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, trajtimi i pretendimeve të ngritura në ankim nga subjekti në lidhje me këtë procedim penal, nuk ndikon në vendimmarrjen e Kolegjit.

➤ *Lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2009 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër:*

74. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit në lidhje me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2009 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër se: *marrja e huasë në një vlerë të konsiderueshme dhe pa interes nga shtetasi P. G., vlerësohet si një pengesë potenciale e subjektit për të ushtruar detyrën e prokurorit me integritet dhe i pavarur ndaj çdo ndikimi dhe presioni të jashtëm, sikurse parashikohet nga pika 3 e nenit 75 të ligjit nr. 96/2016 dhe, ashtu sikurse orientohet në opinionin e ONM-së, marrja e huasë në vlerën 50.000 euro nga ky shtetas, konsiderohet si sjellje që vjen në kundërshtim me etikën e prokurorit dhe cenon integritetin e tij.*
75. Subjekti i rivlerësimit e kundërshton këtë vlerësim të Komisionit si të pambështetur në fakte dhe në ligj, duke pretenduar se:

<sup>23</sup> Që lidhet me praktikën nr. {\*\*\*}, datë 28.01.2020, sipas informacionit të marrë nga burimet arkivore.

<sup>24</sup> Sipas faqes zyrtare në internet të KLP-së.

<sup>25</sup> Sipas paragrafit nr. 176 të vendimit të Komisionit.

(i) Gjatë hetimit administrativ është provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se huaja është marrë nga shtetasi P. G. si individ dhe jo nga shoqëria ku ai ishte administrator dhe dyshimi i Komisionit në këtë drejtim, është i pabazuar në të dhënat apo rrethanat objektive. Huaja është marrë në vitin 2012, shumë kohë më përpara periudhës që referon Komisioni në lidhje me procedimet penale ndaj kësaj shoqërie dhe se ai asnjëherë nuk ka kryer hetime ndaj huadhënësit apo ndaj shoqërisë së tij dhe se, nga ana e Komisionit, nuk është konstatuar konflikt interesi në këtë drejtim.

(ii) Argumenti i Komisionit se subjekti duhet të shmangte marrjen e kësaj huaje në vitin 2012 nga ky shtetas, i cili ishte administrator i shoqërisë “{\*\*\*}” ShA, për shkak se prej tij janë kryer verifikime në kuadër të një procedimi penal, ndonëse jo në ngarkim të kësaj shoqërie, është i palogjikshëm, pasi shoqëria “{\*\*\*}” ShA nuk ka qenë as e kallëzuar, as e dyshuar dhe as nën hetim prej tij. Verifikimet janë kryer për subjektin tregtar të kallëzuar, i cili ka pasur marrëdhënie tregtare me shoqërinë “{\*\*\*}” ShA. Kjo shoqëri nuk ka precedentë penalë dhe se, referuar akteve të administruara në lidhje me dy procedimet penale të regjistruara në ngarkim të saj në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në vitet 2015 dhe 2019, nuk ka rezultuar që kjo shoqëri të jetë dënuar për ndonjë vepër penale.

(iii) Gjetjet e Komisionit të cilat nuk lidhen me shtetasin P. G., janë pasqyruar vetëm në vendim, për këtë arsye, bashkëlidhur ankimit, paraqitet certifikata e gjendjes gjyqësore të shtetasit P. G..

(iv) Marrja e huasë pa interes nga një person i cili është administrator apo ortak i një shoqërie tregtare, nuk mund të kualifikohet në ndonjë nga situatat e nenit 75 të ligjit nr. 96/2016 apo të Komentarit mbi Parimet e Bangalores për Sjelljen Gjyqësore dhe Komisioni nuk ka përcaktuar se në cilën situatë ndodhet subjekti. Parashikimet e pikës 113 të Komentarit mbi Parimet e Bangalores, nuk janë relevante në rastin konkret. Ky është rasti i parë në historikun e vendimeve të organeve të rivlerësimit kur marrja e një huaje pa interes nga një përfaqësues i një subjekti tregtar, konsiderohet shkelje etike dhe sidomos kur vetë Komisioni ka arritur në konkluzionin se në rastin konkret nuk ka konflikt interesi as faktik dhe as në dukje, si dhe nuk është evidentuar ekzistenca e trajtimit preferencial. Marrja e huasë nga një person i njohur nuk është një veprim i dënueshëm gjatë kryerjes së detyrës nga një prokuror, dhe situata e ngritur në “Opinionin” e vëzhguesit ndërkombëtar nuk gjen zbatim në rastin konkret, pasi nuk konstatohet asnjë rrethanë apo veprim, shkelje etike e cila të çon në humbjen e besimit të publikut.

(v) Mbajtja e qëndrimeve të ndryshme nga Komisioni për çështje të njëjta, bie në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike dhe me parashikimet e nenit 6/1 të KEDNj-së, si dhe me jurisprudencën e GjEDNj-së (*Svilengacandin dhe të tjerët kundër Serbisë*) dhe jurisprudencën e Kolegjtit në vendimet nr. 42, datë 18.11.2022, si dhe nr. 34, datë 21.09.2022 të tij.

76. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues, pasi analizoi aktet e fashikullit të Komisionit dhe arsyetimin e tij lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, konstatoi sa më poshtë.

77. Me qëllim verifikimin e pretendimeve të ngritura në denoncimin e Shoqatës Shqiptare të {\*\*\*} ndaj subjektit të rivlerësimit, ku pretendohet ekzistenca e konfliktit të interesit në trajtimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2009, Komisioni administroi pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, dosjen e këtij procedimi penal. Nga aktet e administruara, rezultoi se: (i) më 12.11.2009, bazuar në kallëzimin penal nr. {\*\*\*}, datë 27.10.2009, të paraqitur nga DRT Tiranë

në lidhje me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal ndaj kësaj shoqërie për veprën penale të “Fshehjes së të ardhurave”; (ii) më 14.09.2010, subjekti ka urdhëruar kryerjen e një sërë veprimesh hetimore, ndër të cilat marrjen e informacionit nga QKR-ja, bankat dhe organet tatimore për shoqërinë nën hetim, si dhe për dy subjekte të tjera tregtare, konkretisht “{\*\*\*}” ShA dhe “{\*\*\*}” ShA; (iii) më 06.06.2011, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2009.

78. Me kontratën e titulluar “Kontratë huaje për shumë të hollash” me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 4 korrik 2012, subjekti i rivlerësimit ka marrë hua nga shtetasi P. G. shumën 50.000 euro, me qëllim blerjen e një apartamenti banimi nga ana e huamarrësit, me afat deri në marrjen e një kredie apo edhe për një afat tjetër 10 vjet.
79. Komisioni administroi gjithashtu shpjegimet e dhëna nga subjekti pranë ILDKPKI-së në vitin 2016, lidhur me marrëdhënien me shtetasin P. G., në të cilat subjekti ka deklaruar se ky i fundit është mik i tij nga Shkodra.
80. Me qëllim verifikimin nëse subjekti, gjatë trajtimit të procedimit penal nr. {\*\*\*}/2009, ndodhej në kushtet e ekzistencës së shkaqeve të njëanshmërisë, të parashikuara nga nenet 17 dhe 26 të Kodit të Procedurës Penale, Komisioni e ftoi atë të jepte shpjegime lidhur me marrëdhënien me shtetasin P. G. dhe periudhën e krijimit të saj. Në përgjigje, subjekti deklaroi se me z. P. G. ka marrëdhënie shoqërore dhe miqësore prej disa vitesh dhe se e ka njohur atë rreth vitit 2011, nëpërmjet mikut të tij, z. K. L.. Më tej, ai deklaroi se nuk kanë kryer udhëtime të përbashkëta jashtë shtetit me këtë shtetas, deklarim i cili u konfirmua edhe nga të dhënat e sistemit TIMS.
81. Në gjetjen dhe opinionin e datës 07.12.2022, të bazuar në nenin 49, pikat 10 dhe 11 të ligjit nr. 84/2016<sup>26</sup>, vëzhguesi ndërkombëtar i çështjes ka vlerësuar se situata që lidhet me marrjen nga subjekti i rivlerësimit të një huaje nga shtetasi P. G. në vitin 2012, ngre dyshime serioze në drejtim të respektimit të etikës nga subjekti. Për këtë arsye, ai i ka kërkuar Komisionit ta mbajë në konsideratë këtë rrethanë në kuadër të vlerësimit të etikës dhe të vlerësimit të përgjithshëm të çështjes.
82. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për paraqitjen e provave dhe shpjegimeve lidhur me konstatimin se ai kishte shfaqur mungesë të etikës profesionale, sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, për shkak të marrëdhënieve me shtetasin P. G.. Në shpjegimet e dhëna mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar të njëjtin qëndrim si më lart.
83. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në këtë shkak ankimi, në raport me situatën faktike të konstatuar më sipër dhe konkluzionet e Komisionit në vendim, trupi gjykues konstaton se Komisioni e ka bazuar përfundimin për shkelje të etikës nga subjekti i rivlerësimit në vlerësimin si të pabesueshëm të shpjegimit të tij se kishte marrë një hua afatgjatë, pa interes dhe

---

<sup>26</sup> Neni 49 i ligjit nr. 84/2016, “Mjetet e kërimit të provës”, në pikën 10, parashikon: “Gjetja, e paraqitur në formën e një deklaratë, dokumenti ose raporti të dhënë nga vëzhguesi ndërkombëtar, përbën provë që dëshmon një fakt, rrethanë ose standard ligjor, i cili ekziston ose ka ndodhur”. Ky nen në pikën 11, parashikon: “Një mendim me shkrim i dhënë nga vëzhguesit ndërkombëtarë, konsiderohet një përfundim i dhënë për një rrethanë konkrete gjatë procesit të rivlerësimit ose që rezulton nga faktet në çështje të veçanta. Mendimi mund të ndikojë në vendimmarrjen e Komisionit ose të Kolegjit të Apelimit, por nuk ka vlerën e provës”.

në vlerën 50.000 euro, nga një person të cilin pretendonte se e njihte prej vetëm një viti në kohën e marrjes së huasë. Komisioni ka vlerësuar gjithashtu se subjekti duhej të kishte shmangur marrjen e kësaj huaje nga ky shtetas, i cili rezultonte administrator i një shoqërie tregtare për të cilën subjekti i rivlerësimit kishte kryer veprime verifikuese në kuadër të ushtrimit të detyrës si prokuror, gjatë hetimeve ndaj një subjekti tjetër tregtar. Qëndrimi i Komisionit mbështetet edhe në gjetjen dhe opinionin e vëzhguesit ndërkombëtar, të paraqitur pranë Komisionit më datë 07.12.2022.

84. Çështjet etike në lidhje me sjelljen e subjektit të rivlerësimit, në vlerësimin e trupit gjykues, lidhen me faktin se etika nuk gjen zbatim vetëm në përmbushjen e detyrave funksionale të gjyqtarit apo prokurorit, por përfshin gjithashtu edhe sjelljen në jetën private dhe veprimtarinë jashtëgjyqësore. Kjo sjellje zë një vend po aq të rëndësishëm, duke marrë karakterin e një vlere themelore, e cila gjen pasqyrim në nenin 3, pika 5 e ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit sjellja e magjistratit, si gjatë ushtrimit të funksionit, ashtu edhe jashtë tij, duhet të garantojë ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.
85. Deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 96/2016, rregullat lidhur me sjelljen e prokurorëve parashikoheshin nga ligji nr. 8737/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili, në nenin 32, shkronja “dh”, përcaktonte se kryerja e veprimeve të papajtueshme me funksionet e prokurorit përbënte shkelje disiplinore. Rregullat mbi sjelljen e prokurorëve janë trajtuar gjithashtu në Komentarin e Parimeve të Bangalores për Sjelljen Gjyqësore<sup>27</sup>, si dhe në Udhëzimet Evropiane “Mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve”, të miratuara nga Konferenca e 6-të e Prokurorëve të Përgjithshëm të Evropës (Budapest, maj 2005), të cilat kanë shërbyer si bazë edhe për rregullat e etikës dhe sjelljes së prokurorëve në Shqipëri. Në këto dokumente është përcaktuar se: “[...] edhe në sjelljen në jetën private, prokurorët duhet të kujdesen për të ruajtur dhe forcuar besimin e publikut në profesionin e tyre [...]”<sup>28</sup>. Po aty, fitimi dhe ruajtja e besimit të publikut lidhen drejtpërdrejt me sjelljen e prokurorëve në çdo rrethanë. Në këtë kuptim, gjyqtarët<sup>29</sup> dhe prokurorët, përveç detyrimit për respektimin e ligjit si çdo person tjetër, duhet të sillen me integritet, ndershmëri, vetëpërmbytje dhe diskrecion, si gjatë ushtrimit të detyrës<sup>30</sup>, ashtu edhe jashtë saj. Ata nuk duhet të shfaqin sjellje, edhe kur këto janë formalisht të ligjshme, që cenojnë besueshmërinë personale, dinjitetin e tyre ose prestigjin e

<sup>27</sup>[https://www.unodc.org/res/ji/import/international\\_standards/commentary\\_on\\_the\\_bangalore\\_principles\\_of\\_judicial\\_conduct/bangalore\\_principles\\_english.pdf](https://www.unodc.org/res/ji/import/international_standards/commentary_on_the_bangalore_principles_of_judicial_conduct/bangalore_principles_english.pdf)

<sup>28</sup> <https://rm.coe.int/conference-of-prosecutors-general-of-europe-6th-session-organised-by-t/16807204b5>

<sup>29</sup> Në lidhje me gjyqtarët, shih Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke ndjekur jurisprudencën e saj të mëparshme në çështjen *Vogt kundër Gjermanisë* (vendimi i datës 26.09.1995, *Dhoma e Madhe*, aplikimi nr. 17851/91) dhe çështjen *Kurtulmus kundër Turqisë* (vendimi i datës 24.01.2006, aplikimi nr. 65500/01), mbajtur në çështjen *Ozpinar* (vendimi i datës 19.10.2010, aplikimi nr. 20999/04, në par. 71) që magjistratët kanë detyrë të rezervohen edhe në jetën e tyre private.

<sup>30</sup> Shih: *Parimet Bangalore të Sjelljes Gjyqësore*, miratuar në 2002 (në dispozicion në: [www.unodc.org](http://www.unodc.org)); *Opinionin nr. 3 i CCJE-së në vëmendje të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi parimet dhe rregullat që rregullojnë sjelljen profesionale të gjyqtarëve, në veçanti etikën, sjelljen e papajtueshme dhe paanshmërinë*, miratuar në 2002 (e disponueshme në: [http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/ccje/texte\\_vis\\_en.asp](http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/ccje/texte_vis_en.asp)), paragrafi 29; *Grupi i Punës i ENCJ, Raporti i Etikës Gjyqësore 2009-2010, i disponueshëm në: www.encj.eu/images/stories/pdf/ethics/judicialethicsdeontologiefinal.pdf. Këto parime mund të zbatohen, mutatis mutandis, edhe për prokurorët.*

institucionit ku ushtrojnë funksionin, pasi çdo sjellje që cenon pavarësinë apo paanshmërinë, qoftë edhe në aspektin e dukjes së saj, përbën shkelje.

86. Në rrethanat faktike konkrete, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, gjatë ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka marrë hua në një vlerë të konsiderueshme dhe për një afat të gjatë, nga shtetasi P. G., ndaj të cilit rezulton se më parë, në kuadër të ushtrimit të detyrave të tij funksionale pranë kësaj prokurorie, kishte kryer veprime procedurale verifikuese në funksion të procedimit penal nr. {\*\*\*/2009. Pavarësisht se hetimet janë zhvilluar ndaj një subjekti tjetër tregtar dhe jo ndaj shtetasit P. G. apo subjektit tregtar “{\*\*\*}” ShA, të administruar prej tij, kjo sjellje, në vlerësimin e trupit gjykues, nuk përputhet me standardin e sjelljes që pritet të respektojnë gjyqtarët dhe prokurorët (*mutatis mutandis*).
87. Subjekti i rivlerësimit nuk ka treguar kujdesin dhe vëmendjen e duhur në veprimet e tij, për të shmangur krijimin e perceptimit, nga këndvështrimi i një vëzhguesi të jashtëm, se ka vepruar i pandikuar. Marrëdhënie të tilla dhe sjellja e subjektit, të denoncuar edhe nga publiku, duhet të analizohen në funksion të ndikimit që ato kanë në perceptimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, pasi ato rrisin ndjeshmërinë lidhur me natyrën e këtyre marrëdhënieve dhe krijojnë një perceptim negativ mbi mënyrën e realizimit të drejtësisë.
88. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se sjellja e magjistratit edhe jashtë ushtrimit të funksionit merr rëndësinë e një vlere themelore, sikurse parashikohet në nenin 3 të ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit magjistrati, si gjatë ushtrimit të funksionit, ashtu edhe jashtë tij, duhet të garantojë ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Jashtë ushtrimit të funksioneve të tij, magjistrati nuk duhet të shfaqë sjellje që cenojnë besueshmërinë personale, dinjitetin e tij apo prestigjin e institucionit gjyqësor, pasi sjellje të tilla krijojnë dyshime mbi pavarësinë dhe paanshmërinë e tij, qoftë edhe në aspektin e dukjes.
89. Në kundërshtim me pretendimin e subjektit se Komisioni, në vendimin e tij, ka bërë konstatime lidhur me procedime penale ndaj z. P. G., trupi gjykues vëren se Komisioni nuk ka evidentuar ekzistencën e procedimeve penale në ngarkim të këtij shtetasi. Edhe pse Komisioni ka kryer hetime lidhur me ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesit, kushteve të njëanshmërisë apo trajtimit preferencial në raport me këtë shtetas, në vendim nuk rezulton të jenë referuar gjetje që lidhen me precedentë penalë të tij.
90. Për sa më sipër, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit se Komisioni ka bërë gjetje për procedime penale në ngarkim të shtetasit P. G.. Për rrjedhojë, certifikata e gjendjes gjyqësore e z. P. G., e paraqitur nga subjekti së bashku me ankimin në cilësinë e provës së re, në mbështetje të nenit 49, pika 6, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, nuk mund të pranohet si provë e re.
91. Në lidhje me pretendimin e subjektit se shoqëria “{\*\*\*}” ShA nuk është shoqëri me precedentë penalë, trupi gjykues konstaton se, referuar informacionit të administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ndaj subjektit tregtar “{\*\*\*}” ShA janë zhvilluar hetime në kuadër të procedimit penal nr. {\*\*\*/2015, për veprën penale “Ruajtja dhe depozitimi i mallrave kontrabandë”, parashikuar nga neni 179 i Kodit Penal dhe për veprën penale “Fshehja e të ardhurave”, parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal. Subjekti i rivlerësimit është caktuar

fillimisht si prokuror i këtij procedimi penal, me vendimin e datës 22.04.2016 të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, por më pas është zëvendësuar, pasi ka paraqitur aktin e heqjes dorë nga hetimi i çështjes, duke deklaruar: *Pasi jam njohur me materialin hetimor të këtij procedimi, kam konstatuar se administratori i subjektit tregtar në hetim është shtetasi P. G.. Me këtë shtetas kam njohje miqësie.* Ky procedim penal është pushuar me vendimin e datës 09.06.2016 të prokurorit zëvendësues, Xh. L..

92. Ndërkohë, për operatorin ekonomik “{\*\*\*}” ShA, të administruar nga z. P. G., janë zhvilluar hetime në kuadër të procedimit penal nr. {\*\*\*}/2019 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër. Ky procedim është trajtuar nga prokuroret A. P. dhe E. N. dhe është pushuar më datë 19.11.2019.
93. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh në vitin 2016 me faktin se zyra e prokurorisë pranë së cilës ai ushtronte detyrën e prokurorit, po zhvillonte hetime ndaj shoqërisë tregtare “{\*\*\*}” ShA, me ortak dhe administrator huadhënësin e tij P. G., nuk duhej të ishte mjaftuar vetëm me heqjen dorë nga kjo çështje, por ai duhet të merrte masa për përfundimin e marrëdhënies së huasë me këtë shtetas në mënyrë që kolegët e tij prokurorë dhe shtetasit e tjerë të mos perceptonin se huadhënësi mund të favorizohej nga ndikimi i subjektit të rivlerësimit për shkakun se ishte debitor ndaj tij.
94. Një situatë e ngjashme është krijuar edhe në vitin 2019 me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2019, në të cilin janë zhvilluar hetime ndaj shoqërisë tregtare “{\*\*\*}” ShA, me ortak dhe administrator huadhënësin P. G..
95. Nga aktet e fashikullit të Komisionit, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka vazhduar të jetë debitor ndaj shtetasit P. G. për një periudhë të gjatë kohe, nga data 04.7.2012 deri më datë 28.5.2021. Në kushtet kur huadhënësi qendrën e aktivitetit të tij e kishte në qytetin e Shkodrës, në të cilin subjekti i rivlerësimit ushtronte detyrën e prokurorit, ai duhet të merrte masa për shmangien e një marrëdhënieje e cila rezultoi se e kufizoi atë në kryerjen e detyrës dhe e ekspozoi ndaj perceptimit se ishte cenuar imuniteti i tij ndaj çdo ndikimi ose presioni të jashtëm.
96. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues vlerësoi se marrja e huasë nga shtetasi P. G. në një shumë të konsiderueshme dhe për një afat të gjatë është kthyer për subjektin e rivlerësimit në një pengesë potenciale për ushtrimin e detyrës me integritet, në kuptim të pikës 4 të nenit 73 dhe pikës 3 të nenit 75 të ligjit nr. 96/2016.
- *Lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2010<sup>31</sup> të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër:*
97. Komisioni ka vlerësuar se, *duke mbajtur në konsideratë parimet e Bangalores, ashtu sikurse dhe vëzhguesi ndërkombëtar orienton, sipas të cilave etika nuk zbatohet vetëm në përmbushjen e detyrave të gjyqtarit apo prokurorit, por ajo përfshin edhe sjelljen në jetën private dhe aktivitetet jashtëgjyqësore, udhëtimi i subjektit me shtetasin P. M., i cili ishte marrë si i pandehur nga vetë subjekti rreth një vit e gjysmë më parë, shoqëruar me disa problematika procedurale, sikurse*

---

<sup>31</sup> Marrë në shqyrtim në kuadër të denoncimeve nga Shoqata Shqiptare {\*\*\*}.

*është evidentuar më sipër në këtë vendim, vlerësohet si cenim i etikës së prokurorit dhe besimit të publikut te subjekti si pjesë e sistemit të drejtësisë.*

98. Subjekti kundërshton si të padrejtë konkluzionin e Komisionit se deklarimi i tij për mosnjohjen me shtetasin P. M., është i pabesueshëm, pasi, sipas tij, të gjitha provat e administruara tregojnë se ankuesi nuk ka njohje me shtetasin P. M., udhëtimi ka qenë një rastësi dhe për një kohë shumë të shkurtër dhe se nuk mund të penalizohet me një masë kaq të rëndë vetëm për shkak të këtij udhëtimi, i cili është kryer gati dy vjet pasi hetimi për procedimin penal nr. {\*\*\*}/2010 është pushuar. Në rastin konkret, sipas tij, nuk është konstatuar ndonjë nga indikatorët e parashikuar në nenin 75 të ligjit nr. 96/2016, që të bazohet në tregues që dalin nga mendimi negativ i drejtuesit të prokurorisë apo vendimi përfundimtar për marrjen e ndonjë mase disiplinore brenda periudhës përkatëse të vlerësimit, ndërsa vetë Komisioni nuk ka konstatuar ndonjë situatë të mundshme të konfliktit të interesit.
99. Subjekti pretendon se zgjatja e afateve të hetimit është diktuar nga natyra komplekse e çështjes, pasi për efekt të hetimit janë kryer një numër i lartë i veprimeve hetimore. Vendimet për shtyrjen e afatit të hetimeve janë diktuar nga nevoja të hetimit, si dhe për të administruar një volum të madh dokumentacioni. Në rastin e tij, Komisioni ka marrë vendim të ndryshëm për situata të ngjashme me subjekte të tjera<sup>32</sup>.
100. Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të Komisionit lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2010 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, trupi gjykues konstaton si vijon.
- 100.1. Referuar të dhënave nga sistemi TIMS, rezulton se subjekti ka udhëtuar me automjetin me targë {\*\*\*} në datën 16.02.2013 (dalje) nga Shqipëria, në orën 09:00, në pikën kufitare Hani i Hotit dhe (hyrje) në Shqipëri në të njëjtën pikë kufitare në orën 13:25 minuta. Po në këtë datë dhe në të njëjtat orare, rezulton të ketë udhëtuar me të njëjtin automjet dhe shtetasi P. M..
- 100.2. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni e ka ftuar subjektin të japë shpjegime në lidhje me pronarin e automjetit me targë {\*\*\*} dhe qëllimin e udhëtimit. Në lidhje me sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se, në atë periudhë, automjeti ka qenë në pronësi të z. S. P., prokuror në Kukës dhe se qëllimi i udhëtimit ka qenë për pazare ushqimore për shtëpinë.
101. Shtetasi P. M. është përfaqësues i shoqërisë tregtare “{\*\*\*}” ShPK, me NIPT {\*\*\*}, me ortak shtetasit F. M. dhe P. M.. Referuar dokumentacionit të QKB-së, rezulton se shtetasi P. M. është i autorizuar nga administratori i shoqërisë F. M. për të kryer veprime në emër të saj<sup>33</sup>.
102. Komisioni administroi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër dosjen e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2010, nga analiza e akteve të së cilës rezulton se:
- 102.1. Me urdhrin e datës 28.01.2010, subjekti ka regjistruar procedimin penal nr. {\*\*\*}/2010, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, si dhe ka deleguar kryerjen e veprimtarisë hetimore Oficerit të Policisë Gjyqësore S. P..

---

<sup>32</sup> Subjekti i referohet vendimit nr. 176, datë 08.07.2019, të Komisionit, si dhe vendimit nr. 42, datë 08.11.2022, të Kolegjit.

<sup>33</sup> Nga aktet e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2010, rezulton se ky shtetas është drejtuesi ligjor i shoqërisë.

**102.2.** Më datë 15.06.2010, ai ka urdhëruar regjistrimin e emrit të subjektit juridik “{\*\*\*}” ShPK dhe shtetasit P. M., në regjistrin e njoftimit të veprave penale, me arsyetimin se nga materialet hetimore për këtë procedim, janë konstatuar të dhëna të mjaftueshme për të ngritur dyshimin se shtetasi P. M., administrator i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, ka falsifikuar dhe përdorur dokumente të falsifikuara.

**102.3.** Afati për kryerjen e hetimeve në lidhje me këtë procedim penal, rezulton të jetë zgjatur pesë herë<sup>34</sup>, me arsyetimin se hetimi i këtij procedimi penal nuk u përfundua në afatin e caktuar dhe është e nevojshme kryerja e veprimeve të tjera hetimore. Nga përmbajtja e këtyre vendimeve, vërehet se ato janë të njëjta në formë e në përmbajtje, në asnjë prej tyre nuk janë përcaktuar veprimet hetimore konkrete që duhet të kryhen në afatin e shtyrë të hetimeve, si dhe nuk rezulton të jetë argumentuar pamundësia objektive për t’i përfunduar hetimet brenda afatit të zgjatur.

**102.4.** Më datë 13.07.2011, shtetasi P. M. ka dhënë deklaratimet e tij pranë Oficerit të Policisë Gjyqësore S. P..

**102.5.** Më datë 20.10.2011, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2010. Nuk rezulton të jetë ushtruar ankim ndaj këtij vendimi.

- 103.** Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit për konstatimet se: subjekti ka treguar mangësi në drejtim të aftësive organizative dhe profesionale në trajtimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2010, në ngarkim të shtetasit P. M., sipas neneve 73 dhe 74 të ligjit nr. 96/2016 dhe se subjekti ka treguar mungesë të etikës profesionale sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, për shkak të marrëdhënieve me këtë shtetas.
- 104.** Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, subjekti ka sqaruar se procedimi penal nr. {\*\*\*}/2010, që lidhet me shtetasin P. M., është regjistruar më datë 28.01.2010, mbi bazën e një shkresë të Degës së Thesarit Malësi e Madhe, e cila në mënyrë të përgjithshme dhe jokonkrete kishte kërkuar kryerjen e hetimeve lidhur me dëmin financiar të shkaktuar nga institucione të ndryshme financiare, ndër të cilat edhe Komuna Qendër, Malësi e Madhe. Sipas subjektit, më datë 15.06.2010, në regjistrin e njoftimit të veprave penale janë pasqyruar emrat e personave që, në zbatimin e kontratave përkatëse, kishin pasur cilësinë e administratorit ose të përfaqësuesit të shoqërive tregtare, si persona të cilëve u atribuohet kryerja e veprës penale.
- 105.** Subjekti ka përshkruar në mënyrë të detajuar veprimet hetimore të kryera, duke iu referuar akteve shkresore që provojnë kryerjen e tyre, dhe ka shpjeguar se marrja e pesë vendimeve për zgjatjen e afatit të hetimeve paraprahe, është diktuar nga kompleksiteti dhe dinamika e çështjes. Sipas tij, në kundërshtim me konkluzionet e Komisionit, hetimi ka pasur vazhdimësi dhe densitet në kryerjen e veprimeve hetimore, të imponuara nga natyra komplekse e çështjes. Në këtë kuadër, janë kryer rreth 40 veprime hetimore të shtrira në kohë sipas nevojave të hetimit dhe është administruar një volum i konsiderueshëm dokumentacioni, që përfshinte praktikën e shtatë tenderëve, kontratat përkatëse dhe dokumentacionin që pasqyrore rezultatet e veprimeve hetimore.

---

<sup>34</sup> Në datat: 15.9.2010; 15.12.2010; 15.3.2011; 15.06.2011; 15.9.2011.

106. Në lidhje me udhëtimin e datës 16.02.2013 me shtetasin P. M., subjekti ka sqaruar se ky udhëtim, i kryer në një ditë të shtunë, kishte si qëllim kryerjen e blerjeve ushqimore në qytetin e Podgoricës, së bashku me shtetasin S. P.. Sipas deklarimeve të tij, pasi ka biseduar me z. S. P., është kujtuar se ky i fundit, i cili në atë kohë ushtronte funksionin e prokurorit në Kukës, është takuar rastësisht me shtetasin P. M. në pikën kufitare të Hanit të Hotit. Duke qenë se udhëtimi do të ishte i shkurtër dhe kthimi parashikohej të bëhej brenda pak orësh, z. M. i kishte kërkuar z. P. të udhëtonte me automjetin e tyre deri në Tuz, qytet rreth 16 km larg kufirit.
107. Subjekti ka deklaruar se nuk e kujton shtetasin P. M. dhe se, pavarësisht këtij udhëtimi të rastësishëm, nuk ka njohje me të. Ai ka sqaruar gjithashtu se nuk i kujtohet të kenë zhvilluar biseda pune gjatë këtij udhëtimi të shkurtër dhe se, në atë kohë, nuk kishte ndonjë procedim penal në hetim ndaj këtij shtetasi. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {\*\*\*}, datë 24.12.2022, të shtetasit S. P., në të cilën ky i fundit konfirmon rrethanat e udhëtimit të datës 16.02.2013 me shtetasin P. M., duke mbështetur deklaratimet e subjektit.
108. Në këtë deklaratë noteriale, z. P. ka deklaruar se kishte njohje me shtetasin P. M. për shkak se banonin në të njëjtën zonë, si dhe për faktin se kishte kryer veprime hetimore në kuadër të procedimit penal nr. {\*\*\*}/2010, procedim i cili kishte përfunduar me vendim pushimi shumë kohë përpara zhvillimit të këtij udhëtimi. Ai ka deklaruar më tej se, në atë moment, nuk kishte vlerësuar se ekzistonte ndonjë konflikt interesi, pasi nuk kishte asnjë çështje në hetim ndaj këtij shtetasi apo shoqërisë së tij dhe, në mënyrë të natyrshme e të arsyeshme, duke qenë se në automjet kishte vende të lira, kishte vlerësuar se ai mund të udhëtonte me ta. Gjithashtu, ai ka deklaruar se nuk i kujtohet të ketë pyetur z. Bahiti apo të ketë bërë ndonjë prezantim të posaçëm, pasi nuk i kishte kushtuar rëndësi këtij fakti.
109. Sa i takon pretendimit të subjektit se nuk mund të penalizohet me një masë kaq të rëndë disiplinore vetëm për shkak të një udhëtimi rastësor si pasagjer në të njëjtin automjet me shtetasin P. M., të cilin pretendon se nuk e ka njohur dhe nuk ka pasur marrëdhënie me të, trupi gjykues, sikurse Komisioni, vlerëson se deklaratimet e subjektit lidhur me mosnjohjen e këtij shtetasi dhe rrethanat e udhëtimit nuk rezultojnë bindëse. Kjo për sa kohë subjekti ka pasur nën hetim shtetasin P. M. për një periudhë rreth 16-mujore, në kuadër të procedimit penal nr. {\*\*\*}/2010, hetime të cilat janë kryer nga subjekti i rivlerësimit së bashku me Oficerin e Policisë Gjyqësore S. P., i cili ka qenë i pranishëm në udhëtimin e datës 16.02.2013 dhe njëkohësisht pronar e drejtues i automjetit, dhe deklarimi i këtij të fundit se e njihte shtetasin P. M. për shkak të origjinës së përbashkët dhe të hetimeve të zhvilluara në procedimin penal nr. {\*\*\*}/2010.
110. Në vlerësim të sa më sipër, sa i takon pretendimit të subjektit për kundërshtimin si të pabazuar të konkluzionit të Komisionit lidhur me mungesën e veprimeve hetimore, nga analiza e veprimtarisë hetimore të kryer nga subjekti i rivlerësimit në kuadër të procedimit penal nr. {\*\*\*}/2010, trupi gjykues vëren se pjesa kryesore e veprimeve hetimore, sikurse ka referuar edhe vetë subjekti, rezulton të jetë kryer deri më datë 15.06.2010<sup>35</sup>.

---

<sup>35</sup> Në këtë datë është regjistruar emri i shtetasit P. M., si person të cilit i atribuohet vepra penale.

111. Rezulton se gjatë afatit tremujor, 15.06.2010 – 15.09.2010, janë kryer 11 veprime hetimore; në periudhën 15.09.2010 – 15.12.2010, janë kryer 3 veprime hetimore; në periudhën 15.12.2010 – 15.03.2011, janë kryer po ashtu 3 veprime hetimore; ndërsa në afatin e zgjatur 15.03.2011 – 15.06.2011, evidentohet vetëm një veprim hetimor. Në periudhën 15.06.2011 – 15.09.2011, për të cilën vendimi për zgjatjen e hetimeve mban datën 15.03.2011, të korrigjuar me shënim dore në datën 15.06.2011, evidentohet vetëm pyetja e shtetasit P. M.. Pas datës 15.09.2011, nuk rezultojnë veprime të tjera hetimore, ndërkohë që më datë 20.10.2011, është vendosur pushimi i procedimit penal.
112. Në vlerësimin e trupit gjykues, veprimtaria hetimore e zhvilluar nga subjekti i rivlerësimit gjatë afateve të zgjatura të hetimit, nuk justifikon zgjatjen pesë herë të afatit të hetimeve. Gjithashtu, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka marrë pesë vendime për zgjatjen e afatit të hetimeve, por në asnjërin prej tyre nuk pasqyrohen arsyet e mospërfundimit të hetimeve brenda afatit, shkaqet konkrete të zgjatjes apo veprimet hetimore specifike që duhej të kryheshin. Përmbajtja e këtyre vendimeve rezulton në thelb e njëjtë, duke ndryshuar vetëm data e nxjerrjes së tyre. Për sa më sipër, vendimet e subjektit të rivlerësimit për zgjatjen e afatit të hetimeve janë të pajustificuara në raport me kushtet e parashikuara në nenin 324/2 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit zgjatja e afatit kushtëzohet me kompleksitetin e hetimeve dhe pamundësinë objektive për t'i përfunduar ato brenda afatit.
113. Në përfundim të hetimeve, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2010, pa konstatuar përgjegjësi penale për asnjë prej personave të marrë nën hetim. Për sa më sipër, trupi gjykues e vlerëson të bazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me mangësitë procedurale të evidentuara në zgjatjen e paarsyetuar të afateve të hetimit të kësaj çështjeje nga subjekti i rivlerësimit.
114. Trupi gjykues evidenton edhe në rastin e marrëdhënies së subjektit të rivlerësimit me shtetasin P. M., të njëjtën problematikë në drejtim të etikës së magjistratit, sikurse në rastin e huasë së marrë nga shtetasi P. G.. Në vlerësimin e trupit gjykues, kjo qasje e subjektit nuk paraqitet si një rast i izoluar, nëse mbahet në konsideratë analiza e zhvilluar më sipër në këtë vendim, nga e cila evidentohet një tendencë e subjektit për të krijuar marrëdhënie miqësore, për të marrë hua apo për t'u shoqëruar dhe udhëtuar me individë ndaj të cilëve ai ka kryer më parë veprime verifikuese ose hetimore.
115. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se këto marrëdhënie sjellin pasoja në vlerësimin e etikës dhe integritetit të subjektit të rivlerësimit, pasi ato ndikojnë drejtpërdrejt në perceptimin e publikut mbi integritetin, përgjegjshmërinë dhe paanësinë e organeve të drejtësisë, duke cenuar kështu besimin e publikut në to.
116. Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni ka mbajtur qëndrim të ndryshëm në raste të ngjashme të subjekteve të tjera të rivlerësimit, ku udhëtime të ngjashme nuk janë konsideruar si shkelje, trupi gjykues çmon se, referuar jurisprudencës së Kolegjit, pretendime të tilla nuk mund të përbëjnë apriori shkak për ta konsideruar të padrejtë vendimin e Komisionit. Çdo vendimmarrje e Komisionit i nënshtrohet vlerësimit individual nga Kolegji, mbi bazën e specifikave të rrethanave faktike të provuara gjatë gjykimit dhe zbatimit korrekt të ligjit në raport

me situatën konkrete, dhe jo në varësi të mënyrës së rivlerësimit të subjekteve të tjera nga Komisioni.

117. Në rastin konkret, trupi gjykues, sikurse është arsyetuar më sipër në këtë vendim, vlerëson se, pavarësisht justifikimeve të subjektit të rivlerësimit se marrja e huasë nuk përbën një veprim të paligjshëm apo se udhëtimi ka ndodhur në rrethana rastësore, problematikat e evidentuara në lidhje me marrjen e huasë nga shtetasi P. G., ndaj të cilit rezultoi se subjekti ka kryer më parë veprime procedurale verifikuese, si dhe udhëtimi me shtetasin P. M., i proceduar penalisht prej tij, meritojnë të vlerësohen nga Kolegji, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si sjellje që bien ndesh me standardin e sjelljes që pritet nga një prokuror edhe në jetën jashtë funksionit.

118. Këto sjellje nuk rezultojnë në përputhje me Parimet e Bangalores<sup>36</sup> mbi Sjelljen Gjyqësore, të zbatueshme *mutatis mutandis* edhe për prokurorët, si dhe me Udhëzimet e Budapestit “Mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve publikë”, të miratuara nga Konferenca e Prokurorëve të Përgjithshëm më 31 maj 2005<sup>37</sup>. Për sa më sipër, trupi gjykues mban të njëjtin qëndrim me Komisionin, duke i konsideruar këto sjellje si rrethana që ndikojnë në perceptimin e publikut mbi integritetin, përgjegjshmërinë dhe seriozitetin e organeve të drejtësisë, duke cenuar kështu besimin e publikut në to.

➤ *Lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2014<sup>38</sup> të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës:*

119. Komisioni, pas kontrollit të ushtruar lidhur me këtë procedim penal, në vendim ka vlerësuar se: *mosveprimet e subjektit në funksion të hetimeve sa më të plota për çështjen në fjalë, janë marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor të aftësive profesionale të tij, në raport me të gjitha rrethanat dhe mangësitë e tjera të evidentuara gjatë vlerësimit të aftësive profesionale.*

120. Këtë konkluzion, Komisioni e ka bazuar në përfundimet se:

120.1. *Informacioni i Prokurorisë Shkodër, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 20.12.2022, në raport me rrethanat konkrete të çështjes, nuk mund të përligjë veprimet e kryera nga subjekti.*

120.2. *Përkundër sa arsyetohet, deri në ditën e vendimmarrjes së pushimit, kërkesa nuk u ishte drejtuar autoriteteve italiane, pasi, ashtu sikurse ka rezultuar e vërtetuar, kjo kërkesë është bërë nga subjekti një ditë më vonë pasi është marrë vendimi i pushimit.*

120.3. *Kërkimi i të dhënave me letërporosi nga subjekti pas vendimit të pushimit, në të cilin arsyetohet rëndësia e informacionit nga institucionet e huaja, dëshmon mbi mungesën e një hetimi të plotë me qëllim marrjen e një vendimi sa më të drejtë. Nga ana tjetër, vendimi i pushimit të çështjes është shoqëruar me heqjen e sekuestros preventive mbi llogaritë bankare të shtetasit G. S., duke mundur kështu lejimin e këtij shtetasi për përdorimin e tyre dhe vijimin e*

---

<sup>37</sup> Udhëzimet e Budapestit mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve publikë, miratuar nga Konferenca e Prokurorëve të Përgjithshëm në datën 31 maj 2005, pjesa IV, “Sjellja private”: <https://rm.coe.int/conference-of-prosecutors-general-of-europe-6th-session-organised-by-t/16807204b5>.

<sup>38</sup> Marrë në shqyrtim sipas informacionit nga shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 10.05.2017, e DPPP-së. Referuar akteve të fshikullit penal bashkëlidhur shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 21.07.2022, ky procedim penal mban nr. {\*\*\*}, regjistruar në vitin 2014 dhe, për këtë arsye, do të referohet me këtë numër në këtë vendim.

*veprimtarisë normale, pa u vërtetuar nëse këto vlera janë produkt i ndonjë veprë penale apo aktiviteti kriminal. Për më tepër, vetë subjekti, në parashtrimet e veta, deklaroi se administrimi i të dhënave të përgjigjeve të letërporosive do të shërbente për të hedhur dritë mbi rastin dhe për zgjidhjen në themel të tij.*

**120.4.** *Ky rast është një rast i përsëritur nga subjekti.*

**121.** Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar vlerësimin e Komisionit në lidhje me këtë procedim penal duke pretenduar se:

**121.1.** Vendimi i pushimit është marrë në bazë të të dhënave hetimore të përfuara nga provat përkatëse të administruara në dosje dhe jo jashtë tyre apo bazuar në hipoteza. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 328 të Kodit të Procedurës Penale pasi ishim para rastit të pushimit të çështjes<sup>39</sup>, vendim i cili është kontrolluar nga drejtuesi i prokurorisë dhe është gjetur i drejtë dhe i bazuar.

**121.2.** Provat e administruara të çonin në konkluzionin se transferta nuk është shprehje apo formë e pastrimit të produkteve të veprës penale, por një marrëdhënie civile.

**121.3.** Pasi janë kryer të gjitha veprimet hetimore në Shqipëri, me letërporosi është kërkuar kryerja e disa veprimeve hetimore nga autoritetet gjyqësore italiane, nga administrimi i të cilave do të mund të përftoheshin të dhëna që do të hidhnin dritë mbi rastin për zgjidhjen e tij në themel.

**121.4.** Është praktikë në prokuroritë shqiptare që në raste të tilla prokurori i çështjes nuk mund të mbajë të hapur hetimin, por e mbyll atë duke disponuar, sipas rastit, me vendim pezullimi ose vendim pushimi dhe, me administrimin e letërporosive, ta hapë përsëri hetimin për t'i dhënë zgjidhje përfundimtare rastit. Kjo praktikë është ndjekur edhe nga prokurori tjetër i kësaj çështjeje, i cili më datë 19.12.2016 ka marrë vendim për pezullimin e hetimeve të çështjes penale nr. {\*\*\*/2014 deri në pritjen e letërporosive të dërguara autoriteteve gjyqësore italiane dhe zvicerane.

**121.5.** Pezullimi i çështjes sipas nenit 326 të Kodit të Procedurës Penale, mund të vendoset kur nuk njihet autori ose kur i pandehuri vuan nga ndonjë sëmundje e rëndë, shkaqe të cilat nuk kanë qenë të pranishme në rastin konkret. Me vendimin e pushimit, është disponuar me kthimin e vlerave të transaksioneve sipas nenit 275 të Kodit të Procedurës Penale, pasi sekuestro e humbiste fuqinë. Për vlerat monetare të kthyera për shkak të humbjes së fuqisë së sekuestros

---

<sup>39</sup> *Si para ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale, ashtu dhe me kuadrin ligjor aktual, vendimi i pushimit të procedimit penal nuk ka pasur dhe nuk ka vlerën e vendimit gjyqësor të formës së prerë në kuptimin substancial, për aq kohë sa mund të revokohet nga gjyqtari i seancës paraprake. Edhe para ndryshimeve të miratuara me ligjin nr. 35/2017, datë 30.03.2017, vendimi i pushimit i marrë nga prokurori, nuk ka pasur vlerën e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, pavarësisht se ndaj tij nuk ushtrohej ankim nga palët. Fakti që ndaj vendimit të prokurorit për pushimin e procedimit penal parashikohej e drejta e ankimit, duke i dhënë tagrin gjykatës, për të shqyrtuar jo vetëm kërkimet e paraqitura nga ana e ankuesit, por edhe kontrollin e ligjshmërisë së këtij vendimi, duke verifikuar nëse nga ana e prokurorisë ishin respektuar drejt rastet e parashikuara nga ligji, lidhur me pushimin e çështjes penale, dëshmon për vlerën që ka vendimi i pushimit të prokurorit. Kur vendos shfuqizimin e vendimit, gjykata ka të drejtë të disponojë mbi kryerjen e veprimeve të tjera që kanë lidhje me akuzën dhe me veprimet hetimore të kryera deri në atë çast, në funksion të zbulimit të fakteve dhe të vërtetës për ushtrimin e ndjekjes penale sipas ligjit (vendimi unifikues nr. 3, datë 27.03.2003, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë).*

preventive, në çdo kohë mund t'i kërkohej shtetasit G. S. garanci për shkak të vlerave të tjera monetare që ai ka pasur në Itali dhe Shqipëri.

121.6. Në përgjigje të letërporosive, ndër veprimet e autoriteteve italiane është ajo e pyetjes së shtetasës A. M. P., e cila ka pranuar faktin se paratë e dërguara në Shqipëri, në emër të G. S., janë të sajat dhe ato e kanë pasur burimin nga shitja e pasurive të paluajtshme.

121.7. Hetimet në lidhje me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2014, edhe pse ka kaluar një kohë relativisht e gjatë (më shumë se 8 vjet), vazhdojnë akoma, ndërkohë që ai nuk ka kryer veprime në lidhje me këtë çështje që prej muajit gusht 2014.

121.8. Shkresa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër konfirmon se praktika e ndjekur prej tij është e njëjtë me raste të tjera të hetimeve me letërporosi dhe Komisioni nuk mund të vërë në dyshim një akt zyrtar me fuqi të plotë provuese. Kjo shkresë, sipas tij, është e mjaftueshme për të vërtetuar faktin se praktika e ndjekur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është e njëjtë me raste të ngjashme dhe, për këtë arsye, konkluzioni i Komisionit është i gabuar.

121.9. E njëjta praktikë pune evidentohet edhe në rastin N., ku në dosjen e procedimit penal ka pasur 4 vendime pushimi, të cilat janë marrë në bazë të nenit 328/1, germa “dh” e Kodit të Procedurës Penale, në pritje të letërporosive, vendime të cilat janë miratuar nga tre drejtues të ndryshëm të Prokurorisë Shkodër, fakt që konfirmon ekzistencën e kësaj praktike. Kjo praktikë evidentohet edhe në shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 04.03.2016, të Drejtorisë Task-Forcë në Prokurorinë e Përgjithshme, e cila, pasi ka shqyrtuar ankimin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave ( në vijim “DPPPP”), sipas rregullimit ligjor të parashikuar nga neni 24/5 i Kodit të Procedurës Penale, nuk e ka cenuar vendimin e pushimit duke e gjetur atë të drejtë e të bazuar.

121.10. Bazuar në parashikimet kushtetuese, si dhe në jurisprudencën e Kolegjit, institucionet e rivlerësimit nuk kanë juridiksion të marrin në vlerësim çështje të cilat janë ende në hetim<sup>40</sup> apo të cilat i takojnë juridiksionit kontrollues e vlerësues të ILD-së dhe KLP-së<sup>41</sup>.

122. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit në lidhje me këtë procedim penal, konstatoi si vijon.

123. Bazuar në informacione të marra nga agjencitë ligjzbatuese dhe institucione të tjera, Komisioni<sup>42</sup> ka kërkuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës informacion lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2014, regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Kjo prokurori ka informuar se, në lidhje me këtë procedim penal, më datë 24.11.2014, nga subjekti i rivlerësimit është vendosur pushimi i çështjes. Ky vendim është

<sup>40</sup> Subjekti i referohet vendimit nr. 33, datë 03.11.2021, të Kolegjit.

<sup>41</sup> Subjekti i referohet vendimit nr. 27, datë 21.09.2021, të Kolegjit.

<sup>42</sup> Informacionin sipas shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 10.05.2017, të DPPPP-së për pushimin e disa çështjeve problematike nga ana e subjektit të rivlerësimit, si: pushimi i procedimit penal për rastin S. në Durrës dhe rastin N. në Shkodër. Komisioni kërkoi informacion dhe dokumentacion në lidhje me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2014 nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe në lidhje me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2011 nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

shfuqizuar më datë 04.03.2015 dhe çështja i është caktuar për hetim një prokurori tjetër, i cili ka pezulluar hetimet në pritje të letërporosive të autoriteteve të huaja gjyqësore. Procedimi penal është rifilluar më datë 31.10.2018 dhe aktualisht është nën hetim.

124. Rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, mbi bazën e materialit kallëzues të referuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Durrës, ka regjistruar më datë 02.08.2014, procedimin penal nr. {\*\*\*}/2014, për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Kallëzuesi ka referuar se shtetasi G. S. dyshohet për kryerjen e veprimeve me qëllim pastrimin e produkteve të veprës penale nëpërmjet operacioneve bankare. Dyshimi ka lindur nga transfertat bankare të kredituara në llogarinë e këtij shtetasi, si dhe nga verifikimet e para që janë kryer në lidhje me emërtesat e këtyre transfertave dhe urdhëruesve të tyre<sup>43</sup>.
125. Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 04.08.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur sekuestron preventive mbi llogarinë bankare në BKT të shtetasit G. S..
126. Me vendimin e datës 12.11.2014, Drejtuesi i Prokurorisë Durrës B. H., pas njohjes me ngarkesën në punë të kësaj prokurorie, ka vendosur zëvendësimin e prokurorit të çështjes A. Sh., me prokurorin Saimir Bahiti.
127. Me vendimin e datës 24.11.2014, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e çështjes penale nr. {\*\*\*}/2014, si dhe ka urdhëruar heqjen e sekuestron preventive mbi shumat e depozituara dhe të bllokuara në llogarinë bankare të shtetasit G. S. në BKT, me argumentin se nuk u provua ekzistenca e faktit sipas materialit kallëzues. Në përmbajtje të këtij vendimi, subjekti ka arsyetuar se: *Pavarësisht sa më sipër mbi pretendimet e ngritura në kallëzimin penal me letërporosi, u është kërkuar autoriteteve kompetente gjyqësore të shtetit italian, kryerja e disa veprimeve hetimore të cilat do të bënin të mundur administrimin e të dhënave hetimore të rëndësishme për evidentimin e fakteve e rrethanat që lidhen me burimin e vlerave monetare të përfshira në transaksionet bankare dhe me vërtetimin e marrëdhënies civile të pasqyruara në referencat e këtyre transaksioneve.*
128. Në vijim, një ditë më pas, me shkresën e datës 25.11.2014, subjekti i rivlerësimit u ka dërguar letërporosi autoriteteve gjyqësore italiane për informacion dhe të dhëna lidhur me shtetasin G. S..
129. Pas ankimit të DPPPP-së, Drejtoria Task-Forcë në Prokurorinë e Përgjithshme, ka vendosur shfuqizimin e vendimit, datë 24.11.2014, për pushimin e çështjes penale nr. {\*\*\*}/2014 dhe vazhdimin e ushtrimit të ndjekjes penale sipas ligjit, me arsyetimin se vendimi i pushimit të

---

<sup>43</sup>Në datën 23.07.2014, në llogarinë e shtetasit G. S. në BKT, është kredituar shuma 199.972 euro. Urdhëruesi i kësaj transferte ka qenë subjekti “{\*\*\*}”, me adresë Panama. Banka urdhëruese ka qenë “Union bancaire Privee, Geneva” Zvicër. Përshkrimi i transaksionit është blerje vile, Durrës, zona {\*\*\*}. Në datën 24.07.2014, në llogarinë e shtetasit G. S. në BKT, është kredituar shuma 242.972 euro, nga i njëjti urdhërues dhe bankë urdhëruese dhe me të njëjtin përshkrim të transaksionit. Në datën 30.07.2014, shtetasi G. S. është paraqitur në bankën BKT dhe ka bërë kërkesë për transferimin e shumës prej 345.000 eurosh te subjekti tregtar “{\*\*\*}” ShPK për të realizuar këmbimin nga euro në lekë. Ndërsa pjesën e mbetur të shumave të kredituara në datat 23 dhe 24 korrik, ka kërkuar ta tërheqë në dorë, cash.

çështjes nuk është arsyetuar drejt dhe është marrë në analizë të gabuar të provave, pa kryer një hetim të plotë dhe të saktë.

130. Në këtë vendim është konstatuar se:

*130.1. Nuk janë administruar provat e përfituara nga veprimet hetimore të kërkuara për t'u kryer nga autoriteti gjyqësor italian, që kanë të bëjnë me sqarimin e burimit /originës së vlerave monetare të përfshira në transaksionet bankare dhe vërtetimin e marrëdhënies civile.*

*130.2. Ndryshe nga sa arsyetohet në vendim, nuk rezulton që vlerat e transaksioneve objekt hetimi, të kryera në dobi të shtetasit G. S., të jenë për blerje vile nga/për shtetasen italiane A. M. P., ashtu sikurse nuk rezulton dhe që të jenë urdhëruar nga kjo shtetase apo që të jenë vlera financiare të saj.*

*130.3. Ndryshe nga sa arsyetohet në vendim, se këto vlera nuk janë produkt i ndonjë vepre penale apo aktiviteti kriminal, nga të dhënat hetimore marrëdhënia civile e shtetasit G. S. me shtetasen italiane jo vetëm nuk justifikohet me prova, por nuk është bindëse.*

*130.4. Ndryshe nga sa arsyetohet në vendim, nuk rezulton të jetë kryer një hetim i plotë dhe i gjithanshëm për të marrë të gjitha të dhënat e nevojshme me qëllim për të konkluduar drejt për ekzistencën e elementeve të veprës penale.*

*130.5. Nuk rezulton të jetë sqaruar në mënyrë të plotë aktiviteti kriminal apo masat e dënimit të dhënë për shtetasin G. S..*

131. Pas shfuqizimit të vendimit të pushimit të datës 24.11.2014, Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, më datë 18.03.2015, ka caktuar për ndjekjen e hetimeve prokurorin G. V., me arsyetimin se prokurori i çështjes, subjekti i rivlerësimit, prej disa muajsh ushtronte funksionet në një prokurori tjetër. Në datën 1.6.2015 Zv./Drejtuesi i Prokurorisë A. Gj., për shkak të moskryerjes së asnjë veprimi hetimor lidhur me këtë çështje, ka vendosur zëvendësimin e prokurorit G. V. me prokurorin A. Sh., i cili më datë 19.12.2016, ka vendosur pezullimin e hetimeve me qëllim administrimin e përgjigjeve të letërporosive ndërkombëtare.

132. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për sa konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit penal pa administruar provat e kërkuara nga autoritetet gjyqësore italiane, që kanë të bëjnë me sqarimin e burimit/originës së vlerave monetare të përfshira në transaksionet bankare dhe vërtetimin e marrëdhënies civile dhe se subjekti nuk ka kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të marrë të gjitha të dhënat e nevojshme për ekzistencën e elementeve të veprës penale. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka ngritur të njëjtat pretendime sikurse në ankimi dhe në parashtrimet me shkrim drejtuar Kolegjit.

133. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë shkak ankimi, në raport me situatën faktike të konstatuar më sipër dhe konkluzionet e Komisionit mbi vendimin për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*/2014, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e çështjes penale vetëm mbi bazën e dokumentacionit të administruar nga autoritetet shqiptare, duke vendosur njëkohësisht edhe heqjen e sekuestros mbi llogaritë bankare

të personit nën hetim, pa kërkuar dhe pa pritur përgjigjen e letërporosisë drejtuar autoriteteve italiane.

134. Në vendimin e pushimit të çështjes, subjekti ka arsyetuar se autoriteteve gjyqësore kompetente të shtetit italian u ishte kërkuar, nëpërmjet letërporosisë, kryerja e disa veprimeve hetimore të rëndësishme për evidentimin e fakteve dhe rrethanave që lidhen me burimin e vlerave monetare të transferuara. Megjithatë, rezulton se letërporosia për kryerjen e këtyre veprimeve hetimore, është nisur vetëm një ditë pas marrjes së vendimit për pushimin e procedimit penal dhe pasi ishte vendosur heqja e sekuestros mbi llogaritë bankare të shtetasit G. S..
135. Përkundër pretendimit të subjektit se vendimi për pushimin e çështjes është bazuar në të dhënat hetimore të administruara dhe se provat në dosje nuk krijojnë dyshime se transfertat e kryera përbënin formë të pastrimit të produkteve të veprës penale, trupi gjykues vlerëson se argumentet e paraqitura prej tij nuk përputhen me të dhënat e rezultuara nga kallëzimi penal dhe hetimi i zhvilluar. Këto të dhëna nuk rezultojnë të kenë qenë të pamjaftueshme për krijimin e dyshimit të arsyeshëm mbi ekzistencën e elementeve të veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, për sqarimin e të cilave ishte e nevojshme të kërkohej dhe të administrohej informacioni përkatës lidhur me burimin e të ardhurave, personin që kishte transferuar këto shuma, si dhe marrëdhënien e tij me personin nën hetim.
136. Për sa më sipër, trupi gjykues, njëlloj si Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të kërkuar dhe administruar të gjitha të dhënat e nevojshme në drejtim të verifikimit të ekzistencës së elementeve të veprës penale. Për rrjedhojë, praktika e ndjekur nga subjekti i rivlerësimit nuk rezulton në përputhje me situatën faktike dhe me kërkesat e ligjit procedural penal.
137. Kërkimi i të dhënave me letërporosi një ditë pas vendimit për pushimin e procedimit penal, dëshmon jo vetëm mungesën e një hetimi të plotë e të gjithanshëm, por edhe një nxitim të subjektit për të pushuar procedimin penal dhe për të hequr sekuestron preventive mbi llogarinë bankare të shtetasit G. S., që është arsyetuar nga subjekti si një veprim i cili vinte si rrjedhojë e vendimit të pushimit të çështjes penale. Në këtë kuptim, argumenti tjetër i përmendur nga subjekti i rivlerësimit, se pavarësisht heqjes së sekuestros, në çdo kohë mund t'i kërkohej garanci për shkak të vlerave të tjera monetare që ky shtetas kishte në Itali dhe Shqipëri, vlerësohet jobindës dhe pa vlerë për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk ka treguar kujdes dhe vëmendje të veçantë në këtë drejtim dhe, duke ushtruar një rol pasiv, ka lejuar defekte të dukshme në veprimtarinë e tij hetimore në funksion të zbardhjes së çështjes.
138. Sa i takon pretendimit të subjektit se vendimi për pushimin e procedimit penal, është kontrolluar nga drejtuesi i prokurorisë dhe është gjetur i drejtë e i bazuar, trupi gjykues vëren se, pavarësisht kontrollit dhe vlerësimit të drejtuesit të prokurorisë, referuar akteve të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, rezulton se vendimi i subjektit të rivlerësimit për pushimin e çështjes penale nr. {\*\*\*/2014, është shfuqizuar më datë 04.03.2015, sipas vendimit të Drejtorit të Drejtorisë Task-Forcë pranë Prokurorisë së Përgjithshme, i cili, me shfuqizimin e vendimit të pushimit të çështjes, ka lënë detyra konkrete për Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës në lidhje me zgjidhjen e rastit. Në këtë vendim, është argumentuar në mënyrë të detajuar se vendimi për pushimin e çështjes, datë 24.11.2014, nuk është arsyetuar drejt, është marrë në

analizë të gabuar të provave dhe fakteve, pa kryer një hetim të plotë dhe të saktë për rrethanat dhe faktet në bazë të të cilave është regjistruar procedimi penal, si dhe në shkelje të dispozitave procedurale penale dhe, si i tillë, duhet shfuqizuar. Sa më sipër, pretendimi i subjektit se vendimi është kontrolluar dhe se është gjetur i drejtë e i bazuar, është i pambështetur.

139. Në lidhje me pretendimin e subjektit se vendimi i pushimit është marrë bazuar në nenin 328 të Kodit të Procedurës Penale për shkak se ndodhej përpara rastit të pushimit dhe se, duke mos qenë një vendim përfundimtar, mund të revokohej pasi të administroheshin përgjigjet e letërporosive, sipas praktikës së ndjekur nga prokuroritë në rastet kur kërkohej kryerja e veprimeve hetimore me letërporosi, trupi gjykues konstaton se, në vendimin për pushimin e procedimit penal, subjekti është shprehur: *meqenëse fakti nuk provohet se ekziston*, që i referohet shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale, ndërkohë që baza ligjore e referuar prej tij është shkronja “b” e pikës 1 të të njëjtit nen, i cili parashikon: *fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale*. Pushimi i kësaj çështjeje me këtë bazë ligjore bie ndesh me arsyetimin e përdorur nga subjekti në vendimin për pushim. Po ashtu, praktika e ndjekur nga subjekti nuk bazohet në dispozitën e cituar prej tij (neni 328/1 i Kodit të Procedurës Penale), pasi mungesa e përgjigjes së letërporosisë nuk parashikohet si shkak për pushimin e çështjes.
140. Sa i takon shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 20.12.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, të paraqitur nga subjekti në mbështetje të pretendimeve të tij lidhur me praktikën e pushimit të çështjeve penale, trupi gjykues vëren, së pari, se kjo shkresë është lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ndërkohë që procedimi penal nr. {\*\*\*}/2014 është regjistruar dhe trajtuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
141. Së dyti, referuar përmbajtjes së kësaj shkrese, rezulton se, në rastet e hetimit të çështjeve për të cilat kërkohej kryerja e veprimeve hetimore nëpërmjet letërporosisë drejtuar autoriteteve gjyqësore të shteteve të tjera, procedimi ose pezullohej në përputhje me nenin 326 të Kodit të Procedurës Penale, kur autori i veprës penale nuk dihej, ose pushohej në bazë të nenit 328, pika 1, germa “dh” e këtij Kodi, kur nga provat e mbledhura deri në momentin e dërgimit të letërporosisë, nuk provohej kryerja e veprës penale.
142. Ndërkohë, subjekti i rivlerësimit, në vendimin e pushimit të datës 24.11.2014, ka referuar si bazë ligjore nenin 328, pika 1, germa “b” e Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit “fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale”, ndërkohë që, sikurse është arsyetuar më sipër, letërporosia drejtuar autoriteteve italiane, ende nuk ishte dërguar dhe konkluzioni se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, për sa kohë që subjekti pretendon se duhej hetuar akoma drejt ekzistencës së faktit historik, është kontradiktor me arsyetimin e përdorur në bazë të tij.
143. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se kjo shkresë, përveçse përmban informacion dhe shpjegime të përgjithshme mbi praktikën e ndjekur në raste të ngjashme, nuk evidenton ndonjë rast konkret që të provojë ekzistencën e një praktike të tillë pune dhe as nuk konfirmon se mënyra e procedimit e ndjekur nga subjekti i rivlerësimit në procedimin penal nr. {\*\*\*}/2014, ka qenë e drejtë dhe në përputhje me kërkesat e ligjit.

144. Sa i takon pretendimit të subjektit se e njëjta praktikë është ndjekur edhe nga prokurori tjetër i çështjes, z. A. Sh., i cili me vendimin e datës 19.12.2016<sup>44</sup>, ka vendosur pezullimin e hetimeve të procedimit penal nr. {\*\*\*/2014 deri në mbërritjen e përgjigjeve të letërporosive nga autoritetet gjyqësore italiane dhe zvicerane, trupi gjykues vëren se prokurori A. Sh., në kushtet kur pritej administrimi i përgjigjeve nga autoritetet gjyqësore të huaja, nuk ka proceduar me pushimin e çështjes, por me pezullimin e hetimeve.
145. Në këto rrethana, referimi i subjektit në analogji me vendimmarrjen e prokurorit tjetër të çështjes, nuk mbështet qasjen e pretenduar prej tij, pasi situata procedurale dhe mënyra e procedimit të ndjekur rezultojnë të ndryshme. Për më tepër, subjekti e ka marrë çështjen në dorëzim në datën 12.11.2014 dhe në datën 24.11.2014 ka vendosur pushimin e çështjes. Ngutshmëria e marrjes së këtij vendimi, tregon për mungesë thellimi në njohjen e akteve të çështjes, por edhe vlerësim sipërfaqësor, aq më tepër që ky vendim është shoqëruar me heqjen e sekuestros preventive dhe ka pasur një efekt të drejtpërdrejtë në të drejtat pasurore të personit ndaj të cilit atribuohet kjo vepër penale.
146. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se kjo praktikë nuk mund të merret në shqyrtim nga institucionet e rivlerësimit, për sa kohë çështja është ende nën hetim dhe i përket juridiksionit kontrollues e vlerësues të ILD-së dhe KLP-së<sup>45</sup>, trupi gjykues vlerëson se, referuar vendimit nr. 33/2021 të Kolegjit, konkretisht paragrafit 80 të tij, është çmuar se, bazuar në nenin E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, veprimet procedurale të subjektit nuk mund të jenë objekt rivlerësimi në rastet kur çështja vijon të jetë ende në shqyrtim prej vetë subjektit të rivlerësimit, në fazën kohore të analizuar nga Komisioni.
147. Ndërkohë, referuar rrethanave konkrete të rastit objekt shqyrtimi, trupi gjykues vlerëson se nuk ndodhemi përpara një situatë të ngjashme. Kjo pasi, megjithëse sipas informacionit të përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 11.05.2022, procedimi penal nr. {\*\*\*/2014 rezultonte ende nën hetim në kohën e zhvillimit të procesit të rivlerësimit në Komision, subjekti i rivlerësimit nuk ushtronte më funksione procedurale në kuadër të këtij procedimi penal, duke qenë se rezultoi të ishte zëvendësuar me urdhër të drejtuesit të prokurorisë nga një prokuror tjetër.
148. Po ashtu, rezultoi se vendimi i pushimit i marrë nga subjekti i rivlerësimit, është shqyrtuar nga Drejtoria Task-Forcë, në cilësinë e instancës më të lartë vlerësuese, e cila, me vendimin e datës 04.03.2015, ka vendosur shfuqizimin e këtij vendimi dhe kthimin e akteve Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për vijimin e ndjekjes penale dhe kryerjen e detyrave të lëna.
149. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se referimi i subjektit në vendimin nr. 33/2021 të Kolegjit, nuk rezultoi relevant për rastin objekt shqyrtimi. Po kështu, pa relevancë vlerësohet edhe referimi në vendimin nr. 27/2021 të Kolegjit, pasi, në atë rast, subjekti i rivlerësuar ushtronte

---

<sup>44</sup> Pas shfuqizimit të vendimit të subjektit të rivlerësimit për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. {\*\*\*/2014, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka vijuar me kryerjen e detyrave të lëna nga Prokuroria e Përgjithshme në vendimin për shfuqizimin e vendimit të pushimit të çështjes penale, datë 04.03.2015. Me urdhër të Drejtuesit të Prokurorisë A. Gj., prokurori për vijimin e plotë të hetimeve është caktuar z. A. Sh..

<sup>45</sup> Subjekti u referohet vendimeve nr. 33/2021 dhe nr. 27/2021 të Kolegjit.

funkcionin e drejtuesit/mbikëqyrësit të prokurorisë dhe, sipas vlerësimit të Kolegjit në atë vendim, veprimtaria e tij i nënshtrohej juridiksionit kontrollues dhe vlerësues të ILD-së dhe KLP-së.

150. Ndërsa, në rastin e subjektit të rivlerësimit Saimir Bahiti, Komisioni nuk ka ushtruar kontroll mbi veprimtarinë e tij si drejtues i prokurorisë, por mbi ushtrimin e funksionit të prokurorit në çështjet penale të marra në shqyrtim prej tij. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se kontrolli i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit për këtë çështje, është ushtruar nga Komisioni në përputhje me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që i janë ngarkuar.

151. Në përfundim të kësaj analize, trupi gjykues vlerëson se shkeljet e konstatuara në kuadër të procedimit penal nr. {\*\*\*}/2014, evidentojnë mangësi të subjektit të rivlerësimit në drejtim të kryerjes së një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, si dhe të ndërmarrjes së veprimeve procedurale të pambështetura në situatën faktike dhe në kërkesat e legjislacionit procedural penal. Për rrjedhojë, konkluzioni i arritur nga Komisioni në lidhje me këtë çështje, vlerësohet i drejtë dhe i bazuar.

➤ *Lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2011<sup>46</sup> të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër:*

152. Komisioni, pas kontrollit të ushtruar lidhur me këtë procedim penal, në vendim ka vlerësuar se: *është e vërtetë se sipas nenit 24 dhe 25/2 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti në cilësinë e prokurorit vlerëson provat dhe faktet bazuar në bindjen e tij të brendshme, por në rastin konkret u vërtetua se subjekti nuk ka kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm me qëllim zbardhjen e çështjes, fakt që përkon me informacionet konfidenciale nga organet ligjzbatuese në lidhje me këtë çështje. Përveç kësaj, mospritja e përgjigjeve nga autoritetet e huaja, kërkuar me letërporosi, është një rast i përsëritur nga subjekti. Në këto rrethana, mosveprimet e subjektit në funksion të hetimeve sa më të plota për çështjen në fjalë, janë marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor të aftësive profesionale të tij, në raport me të gjitha rrethanat dhe mangësitë e tjera të evidentuara gjatë vlerësimit të aftësive profesionale.*

153. Këtë vlerësim, Komisioni e ka mbështetur në konstatimet se:

153.1. Subjekti ka vendosur katër herë pushimin e procedimit penal pa administruar përgjigjet e letërporosive të autoriteteve gjyqësore të huaja.

153.2. Në lidhje me mungesën e urdhrit për regjistrimin e emrit të personit të cilit i atribuohet vepra penale, në referencë të jurisprudencës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë<sup>47</sup>,

<sup>46</sup> *Marrë gjithashtu në shqyrtim sipas informacionit nga shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 10.05.2017, e DPPP-së.*

<sup>47</sup> *Në vendimin nr. 2, datë 20.6.2013, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë trajtuar konceptim e subjektit procedural “person të cilit i atribuohet vepra penale”, duke arsyetuar se: “[...] Cilësia e personit, të cilit i atribuohet vepra penale, fillon: a) ose kur njoftuesi i saj mendon se e di se cili mund të jetë autori i veprës penale dhe prokurori shënon paralelisht në regjistrin e njoftimeve të veprave penale, krahas veprës, edhe emrin e personit kur ai njihet, ose b) mbasi është bërë regjistrimi i veprës penale, që nga çasti i mëtejshëm kur nga hetimet rezulton një emër personi të cilit i atribuohet vepra penale. Në këto kushte, nuk ka asnjë dyshim se ky cilësim i përket fazës fillestare të procedimit penal [...]. Emri i personit, të cilit i atribuohet vepra penale, shënohet në regjistër vetëm në ato raste kur ai është i njohur, por mund të këtë edhe raste kur, shpeshherë, kallëzuesi apo autoriteti referues nuk është akoma në gjendje të tregojë se kush mund të mendohet si autor i mundshëm i një vepre penale në fillimin e hetimeve”.*

vlerësohet se argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit nuk qëndrojnë, duke qenë se në rastin konkret, në kallëzimin penal të paraqitur nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Shkodër, identifikohet qartësisht emri i shtetasit A. N. dhe subjekti i rivlerësimit duhet të kishte regjistruar, krahas veprës, edhe emrin e këtij shtetasi si person të cilit i atribuohet vepra penale.

153.3. Subjekti nuk ka kryer veprime hetimore për shtetasin A. N. me mbiemrin e tij të mëparshëm P., bashkëshorten dhe babanë e tij, dhe argumentet e dhëna nga subjekti se për ta nuk ka pasur informacione në materialin fillestar të policisë, nuk qëndrojnë dhe janë tërësisht të pabazuara. Organi i akuzës gëzon të drejtën ekskluzive që i njeh ligji, të kryejë hetime të pavarura, të pakushtëzuara nga veprimtaria hetimore e institucioneve të tjera. Moskryerja e hetimeve të plota në lidhje me të dyshuarin kryesor dhe personat e tij më të afërt, të cilat konsiderohen bazike nga ana e Komisionit në rastin konkret, tregojnë mangësi serioze në drejtim të hetimit të çështjes.

153.4. Nuk rezulton i bazuar as pretendimi i subjektit se ai ka kryer veprime verifikuese në lidhje me identifikimin e shtetasit A. M. si I. V.. Nga aktet e dosjes, konstatohet se subjekti ka administruar shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 25.11.2011, të BKT-së, në të cilën BKT-ja konfirmon se transaksioni është kryer nga shtetasi I. V., por jo veprime të tjera hetimore që e identifikojnë atë si A. M..

153.5. Lidhur me konstatimin mbi mungesën e burimit të shumës 200.000 euro dhe depozitave të tjera bankare, ashtu sikurse konfirmohet edhe nga subjekti, në përfundim të hetimit, ky burim mbeti i paprovuar. Komisioni, duke mbajtur në konsideratë faktin që në një procedim penal, barrën e provës për të provuar kryerjen e veprës penale e ka organi i akuzës, vlerëson se mosvërtetimi i burimit të ligjshëm të shumës 200.000 euro, ka ardhur si pasojë e mungesës së një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm nga ana e subjektit të rivlerësimit.

154. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar si të pabazuar konkluzionin e Komisionit për hetim të paplotë e të gjithanshëm të çështjes, duke pretenduar se mospritja e përgjigjeve nga autoritetet e huaja, kërkuar me letërporosi, është praktikë e unifikuar në të gjitha zyrat e prokurorive. Sipas tij, zyra e Prokurorit të Përgjithshëm ka kryer kontroll mbi këtë çështje mbi bazën e parimit të vetëkontrollit të prokurorisë si organ i centralizuar dhe e ka gjetur të drejtë dhe të bazuar vendimin. Në këtë rast, duhet të mbahen në konsideratë edhe përfundimet e arritura nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 11, datë 02.04.2003, ku, ndër të tjera, arsyetohet se: *Sipas nenit 135 të Kushtetutës, pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, nga gjykata e apelit dhe gjykata e shkallës së parë. Ky pushtet ushtrohet i shkallëzuar sipas parimit të kontrollit të vendimeve të gjykatave më të ulëta nga gjykatat më të larta. Kjo do të thotë se përderisa vendimet nuk janë prishur ose ndryshuar nga një gjykatë më e lartë, asnjë organ tjetër shtetëror, qoftë edhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë, nuk ka të drejtë t'i prekë ato dhe as të ngarkojë me përgjegjësi disiplinore gjyqtarin e çështjes për këto vendime, i cili zbatohet për analogji edhe për vendimet e prokurorëve, vendimmarrja e të cilëve kontrollohet nga prokurori më i lartë ose gjykata.*

155. Në lidhje me veprimet procedurale në hetimin e këtij procedimi, subjekti ka pretenduar se:

155.1. Për hetimin e çështjes penale, janë administruar të dhëna nga burimet përkatëse të informacionit, lidhur me faktet dhe rrethanat që kanë të bëjnë me veprën penale për të cilën është regjistruar procedimi penal, përfshirë Zyrën e Interpolit Tiranë, Drejtorinë Qendrore të

ALUIZNI-t, QKR-në, ZQRPP-në, Zyrën e Gjendjes Civile pranë Qarkut Shkodër, noterët publikë dhe institucionet bankare<sup>48</sup>.

155.2. Bazuar në të dhënat hetimore, është kërkuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, lëshimi i urdhrit për vendosjen e sekuestros preventive ndaj pasurive në emër të shtetasve A. N., P. P., R. S. etj. Gjykata, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 29.05.2012, ka pranuar kërkesën dhe ka vendosur lëshimin e urdhrit të sekuestrimit.

155.3. Sipas dokumentit në gjuhën gjermane, përkthyer në gjuhën shqipe, me rubrikë “Dëshmi lirimi”, shtetasi A. N. është ndaluar nga autoritetet federale gjermane më datë 31.03.2009 dhe ka qëndruar në burg në këtë shtet deri në datën 11.10.2011.

155.4. Për hetimin e çështjes, u është kërkuar me letërporosi, ndihmë juridike në fushën penale, autoriteteve gjyqësore të Gjermanisë, Holandës dhe Belgjikës me qëllim për të pasur informacion për një veprimtari të mundshme të vazhdueshme kriminale apo për të provuar nëse vepra penale e kryer nga A. N. në Gjermani, është rast i shkëputur ose është një rast i përsëritur.

155.5. Me vendimin e datës 07.01.2013, është vendosur pushimi i hetimeve të çështjes penale mbi bazën e shkakut ligjor të parashikuar nga neni 328, pika 1, germa “dh” e Kodit të Procedurës Penale, pasi nga provat e administruara gjatë hetimeve të kryera në Shqipëri, nuk është arritur në përfundimin se pasuria e shtetasve P. P. dhe A. N. përbën produkt të veprës penale. Ky vendim është mbështetur në arsyetimin se transaksionet bankare të kryera nga P. P., A. N. dhe persona të tretë në llogaritë bankare përkatëse, sipas emërtesave të tyre, janë realizuar shumë kohë përpara ndalimit të shtetasit A. N. nga autoritetet gjermane, ndërsa nga hetimi nuk ka rezultuar i provuar ndonjë aktivitet kriminal apo vepër penale e kryer prej këtyre shtetasve, prej së cilës mund të kenë buruar kapitalet monetare dhe pasuritë e tjera në pronësi të tyre.

155.6. Sikurse është përmendur edhe në rastin S., në rastet kur kërkohej ndihmë juridike nga autoritetet gjyqësore të vendeve të tjera, ishte pranuar praktika sipas së cilës prokurori nuk mund ta mbante hetimin të hapur për një kohë të pacaktuar, por duhej ta mbyllte atë duke disponuar, sipas rastit, me vendim pezullimi ose pushimi dhe, pas administrimit të letërporosive, ta rihapte/rifillonte hetimin për t’i dhënë zgjidhje përfundimtare çështjes<sup>49</sup>. Vendimi për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2011, datë 07.01.2013, është miratuar nga drejtuesi i prokurorisë në atë kohë, z. P. K., në cilësinë e prokurorit më të lartë që miratonte zgjidhjen përfundimtare të çështjeve. Ky i fundit, pas mbërritjes së përgjigjes së letërporosisë drejtuar autoriteteve gjyqësore belge, me vendimin e datës 01.04.2013, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit, me qëllim administrimin në dosjen hetimore të të dhënave të ardhura në përgjigje të letërporosisë së dërguar autoriteteve belge.

155.7. Me vendimin e datës 09.07.2013, është vendosur përsëri pushimi i procedimit pasi nga përgjigjja e letërporosisë, kryer nga autoritetet belge, nuk kishte rezultuar asnjë e dhënë e rëndësishme për hetimin. Vendimi i pushimit të procedimit, datë 09.07.2013, është miratuar nga

---

<sup>48</sup> Subjekti ka parashtruar të njëjtat pretendime, si dhe ka dhënë të njëjtat shpjegime të detajuara në lidhje me veprimet hetimore që ka kryer, sikurse me prapësimet ndaj rezultateve të hetimit.

<sup>49</sup> Subjekti i referohet shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 20.12.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.

drejtuesi i prokurorisë, në atë kohë z. B. C., në cilësinë e prokurorit më të lartë që miratonte zgjidhjen përfundimtare të çështjeve. Po ky drejtues, pasi ka mbërritur përgjigjja e letërporosisë drejtuar autoriteteve gjyqësore gjermane, me vendimin e datës 25.10.2013, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit për të administruar në dosjen hetimore të dhënat hetimore të ardhura në përgjigje të letërporosisë.

**155.8.** Me vendimin e datës 11.11.2013, është vendosur përsëri pushimi i procedimit penal pasi nga autoritetet gjermane nuk është dhënë tjetër informacion i rëndësishëm për hetimin, por kanë përmendur vetëm faktin se shtetasi A. N. është kapur në datën 31.03.2009 me 1,15 kg kokainë dhe është dënuar nga Gjykata e Landit Frankenthal në datën 04.12.2009 me katër vjet e tetë muaj burgim, liruar nga burgu në datën 11.10.2011. Drejtuesi i Prokurorisë B. C. ka miratuar vendimin e pushimit në cilësinë e prokurorit më të lartë

**155.9.** Me shkresën nr. {\*\*\*} prot./A.T, datë 04.03.2016, Drejtoria Task-Forcë në Prokurorinë e Përgjithshme Tiranë ka bërë me dije se Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, ka paraqitur ankim kundër vendimit të pushimit të procedimit penal nr. {\*\*\*}/2011. Kjo drejtori, pasi ka tërhequr dosjen e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2011, ka shqyrtuar ankimin ndaj vendimit të pushimit të procedimit, duke arritur në konkluzionin se nga ana e kësaj prokurorie janë kryer të gjitha veprimet e mundshme dhe të duhura hetimore, deri në pritje të letërporosisë nga autoritetet holandeze. Me këtë shkresë, kjo drejtori u ka kërkuar përsëritjen e letërporosisë autoriteteve gjyqësore gjermane, në të cilën të kërkohej vendimi i Gjykatës së Landit në Frankenthal, datë 04.12.2009, si dhe t'i rikujtohet përshpejtimi i kthimit të përgjigjes së letërporosisë nga autoritetet holandeze, siç është kërkuar në letërporosinë drejtuar këtyre autoriteteve.

**155.10.** Marrë shkak nga kjo shkresë, me vendimin e datës 08.03.2016, Drejtuesi i Prokurorisë G. Sh. ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit për të kryer detyrat e udhëzuara nga Drejtoria Task-Forcë në Prokurorinë e Përgjithshme dhe, me vendimin e datës 26.05.2016, është vendosur pushimi i procedimit penal, në pritje të përgjigjes së letërporosisë drejtuar autoriteteve gjyqësore gjermane dhe përgjigjes së letërporosisë drejtuar autoriteteve gjyqësore holandeze, të cilave u është drejtuar një shkresë kujtesë për këtë qëllim.

**156.** Lidhur me gjetjen dhe opinionin e vëzhguesit ndërkombëtar për regjistrimin e emrit të personit të cilit i atribuohet kryerja e veprës penale, neni 287 i Kodit të Procedurës Penale parashikon shprehimisht se prokurori shënon në regjistër çdo njoftim për veprën penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet, si dhe, në të njëjtën kohë ose nga momenti kur rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale. Në rastin konkret, mbi bazën e materialit të referuar nga policia gjyqësore, është kryer regjistrimi i veprës penale, por në atë moment nga materiali hetimor nuk kishin dalë në pah të gjitha elementet përbërëse të figurës së veprës penale për të cilën ishte regjistruar procedimi. Po kështu, edhe gjatë dhe në përfundim të hetimeve, nuk është provuar ekzistenca e veprës penale, pasi pasuritë e P. P. dhe A. N. rezultojnë të krijuara përpara arrestimit të shtetasit A. N. në Gjermani, për shkelje të legjislacionit mbi narkotikët, ndërkohë që nuk është provuar as ndonjë aktivitet tjetër kriminal.

**157.** Cilësimi i veprës penale për të cilën është regjistruar procedimi, kërkon në mënyrë të domosdoshme që aktiviteti kriminal ose vepra penale e origjinës të jetë kryer më parë në kohë

nga vepra penale e pastrimit të produkteve, çka rezulton qartë nga interpretimi i dispozitës që parashikon figurën përkatëse të veprës penale. Për rrjedhojë, regjistrimi i emrit të një personi si autor i veprës penale, bëhet vetëm pasi të provohet kryerja e një vepre penale, gjë që në rastin konkret nuk ka rezultuar.

158. Regjistrimi apriori i emrit të personit të cilit i atribuohet kryerja e veprës penale, jashtë parashikimeve të nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale, do të krijonte probleme serioze për ushtrimin e ndjekjes penale për shkak të ecjes së afateve të hetimit. Kështu, me regjistrimin e emrit të personit, fillon edhe ecja e afateve të hetimit ndaj tij, sipas nenit 323 të këtij Kodi, të cilat duhet të përfundojnë brenda tre muajve. Zgjatja e këtij afati mund të bëhet disa herë me nga tre muaj, në rastet e hetimeve komplekse ose kur ekziston pamundësi objektive për përfundimin e tyre brenda afatit të zgjatur. Megjithatë, afati tërësor i hetimit nuk mund të tejkalohet tre vjet, ku deri në dy vjet zgjatjet miratohen nga drejtuesi i prokurorisë me kërkesë të prokurorit të çështjes, ndërsa përtej këtij afati nga Prokurori i Përgjithshëm.
159. Pas përfundimit të afatit trevjeçar nga momenti i regjistrimit të emrit, nuk mund të mblidhen më prova në ngarkim të personit ose personave të cilëve u është atribuar kryerja e veprës penale. Në këto kushte, çështja ndaj tyre do të shqyrtohej vetëm mbi bazën e provave të administruara brenda afateve ligjore, të cilat, në rastin konkret, nuk provojnë kryerjen e veprës penale. Për pasojë, procedimi do të pushohej dhe do të merrte statusin e gjësë së gjykuar, duke e bërë praktikisht të pamundur dënimin e tyre, edhe në rast se nga administrimi i mëvonshëm i të dhënave hetimore, do të rezultonte kryerja e veprës penale.
160. Lidhur me gjetjen dhe opinionin e vëzhguesit ndërkombëtar se nuk është kryer hetim financiar në emër të A. N. (P.), bashkëshortes së tij dhe personave të afërt të këtij shtetasi, subjekti shpjegon se rasti i kallëzuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër është vënë në lëvizje mbi bazën e informacionit të përcjellë nga DPPP-jë Tiranë, e cila, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 02.12.2010, ka dhënë të dhëna për disa transaksione bankare të kryera në periudhën 11.08.2005 – 13.08.2007 në llogarinë bankare në emër të shtetases P. P., nga kjo e fundit, djali i saj A. N., si dhe persona të tretë.
161. Nga verifikimet e kryera nga kjo drejtori në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, janë identifikuar edhe 9 apartamente në kompleksin “{\*\*\*}” në Velipojë, prej të cilave 8 rezultonin të shitura, ndërsa 1 vijonte të ishte në pronësi të këtij shtetasi. DPPP-jë Tiranë ka informuar se pasuria e shtetasve A. N. dhe P. P. arrinte vlerën prej 420.000 eurosh, e reflektuar si në transaksionet bankare, ashtu edhe në pasuritë e paluajtshme.
162. Subjekti evidenton se as Drejtoria Vendore e Policisë, as Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, të cilat janë marrë me hetimin e çështjes, dhe as DPPP-jë Tiranë nuk kanë përcjellë informacione të tjera hetimore apo indicie shtesë, përtej atyre të përfshira në materialin fillestar kallëzues ose në informacionet e dërguara prej tyre. Në çdo rast, edhe pse individit mund të ketë ndryshuar emrin, ai vijon të mbajë të njëjtin numër identifikimi personal, ndaj hetimi i zhvilluar për personin me emrin e ndryshuar përfshin edhe identitetin e tij të mëparshëm.
163. Nga të dhënat e administruara, nuk rezulton në asnjë moment se bashkëshortja e shtetasit A. N., me shtetësi holandeze dhe banim në Holandë, ka pasur prona apo ka marrë pjesë në lëvizjen e parave ose në tjetërsimin e pasurive në Shqipëri. Po kështu, sipas të dhënave të regjistrimit të

gjendjes civile në Shqipëri, të pasqyruara në certifikatën familjare të shtetasve P. P. dhe A. N., nuk figuron asnjë person tjetër si anëtar i familjes, përveç tyre (certifikata e gjendjes familjare për familjen P., datë 14.09.2012).

164. I vetmi moment kur përmendet emri i bashkëshortes/bashkëjetueses së shtetasit A. N., është në materialin hetimor të administruar nëpërmjet letërporosisë belge, ku përmendet shtetasja M. K.. Megjithatë, nga shqyrtimi i këtij materiali, nuk ka rezultuar asnjë e dhënë me rëndësi për hetimin, që të tregojë ekzistencën e veprimtarisë kriminale apo të pastrimit të produkteve të veprës penale.
165. Po kështu, në informacionin hetimor, nuk përmendet as babai i shtetasit A. N. (i cili kishte ndërruar jetë) dhe nga aktet e administruara në kuadër të hetimit nuk ka rezultuar asnjë e dhënë e tillë, që do të shërbente për një hetim të ndryshëm. Në kushtet kur bashkëshorti i P. P. dhe babai i A. N. ka ndërruar jetë (deklarimi i shtetasve P. P. dhe certifikata e gjendjes familjare për familjen P., datë 14.09.2012, f. 148 e dosjes), hetimi pasuror i tij është ezauruar me hetimin e pasurisë së shtetasve P. P. dhe A. N. si trashëgimtare të tij.
166. Nga hetimi është hedhur dritë dhe është zbardhur tërësisht fakti për sa është pretenduar në informacionin e DPPPP-së Tiranë dhe në materialin kallëzues të Policisë së Shtetit, mbi transaksionet bankare dhe pasuritë e tjetërsuara nga shtetasit P. P. dhe A. N., ku është përfshirë edhe motra e shtetasve P. P.. Po ashtu, janë administruar të gjitha kontratat e shitblerjeve të pasurive të paluajtshme të tjetërsuara ose të përfituara nga shtetasit A. P., P. P. dhe motra e saj.
167. Nuk qëndron konstatimi i Komisionit se arsyetimi i dhënë është në kundërshtim me provat e administruara për rastin e shtetasit I. V.. Në informacionin e DPPPP-së Tiranë theksohet se, në datën 24.04.2007, në llogarinë bankare në emër të shtetasve P. P., është kryer një transfertë në shumën 38.000 euro nga shtetasi A. M.. Më tej, kjo drejtori shprehet se nuk ka qenë i mundur identifikimi i këtij personi mbi bazën e të dhënave që kishte në dispozicion, ndonëse, sipas subjektit, nuk rezulton të jenë verifikuar referencat bankare të transaksionit, nga të cilat identifikohet qartë personi urdhërues i transfertës.
168. Pas administrimit të dokumentacionit bankar pranë bankës BKT, është verifikuar se personi që ka kryer derdhjen e shumës prej 38.000 eurosh, ka qenë shtetasi I. V. (relacioni i policisë gjyqësore, f. 212, si dhe praktika e administruar nga BKT-ja). Në deklarinë e tij, shtetasi I. V. ka pohuar, ndër të tjera, se kishte blerë një apartament nga shtetasi A. N., i ndodhur në kompleksin “{\*\*\*}” në Velipojë. Sipas deklarinës së tij, palët kishin lidhur kontratën përkatëse pranë noterit publik dhe pagesa ishte kryer nëpërmjet transfertës bankare nga llogaria e tij në llogarinë e shitësit. Ai ka deklaruar gjithashtu se burimi i të ardhurave lidhej me punën e djalit të tij emigrant në Angli.
169. Në këto kushte, subjekti vlerëson se është bërë identifikimi i personit që ka kryer transfertën prej 38.000 eurosh, identifikim i cili nuk ishte realizuar më parë nga DPPPP-ja. Për rrjedhojë, në kundërshtim me konkluzionin e Komisionit, nuk mund të kërkohej zhvillimi i hetimeve për identifikimin e një personi tjetër, i cili nuk rezulton të ketë lidhje me rrethanat e faktit apo me veprën penale objekt hetimi, madje pa qenë e qartë as ekzistenca e tij. Nga praktika bankare e BKT-së, rezulton se derdhja është kryer nga shtetasi I. V., ndërsa nuk evidentohet arsyeja pse në përshkrimin e transaksionit është përdorur shkurtimi “A. M.”.

170. Lidhur me konkluzionin se nga hetimi nuk është vërtetuar burimi i shumës prej 200.000 eurosh, subjekti pretendon se vetë shtetasja P. P. ka deklaruar se këto të ardhura burojnë nga puna e saj, e bashkëshortit dhe e djalit në emigracion, në mënyrë informale, ndërkohë që nuk është provuar e kundërta. Pikërisht për këtë arsye, u janë dërguar letërporosi autoriteteve holandeze, gjermane dhe belge. Në kundërshtim me arsyetimin e Komisionit, subjekti vlerëson se janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore dhe se mungesa e provimit të burimit të kësaj shume lidhet me faktin se shtetasja P. P. dhe familja e saj kanë jetuar jashtë shtetit dhe kanë deklaruar se të ardhurat janë krijuar nga puna e tyre në vende të ndryshme të Evropës.
171. Subjekti pretendon se, në një procedim penal, barra e provës për të provuar kryerjen e veprës penale, i takon organit të akuzës. Në rastin konkret, organi i akuzës kishte detyrimin të provonte nëse pasuritë e shtetasve P. P. dhe A. N. buronin nga veprimtari kriminale ose nga produkte të veprës penale, gjë që, sipas subjektit, nuk ka rezultuar nga hetimet e kryera.
172. Ndërsa, sipas subjektit, një regjim krejt i ndryshëm parashikohet nga ligji nr. 9284, datë 30.09.2004, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, sipas të cilit personi i dyshuar (neni 3, pika 1), si dhe personat e tjerë të parashikuar në nenin 3, pika 2 dhe nenin 8 të këtij ligji, mbajnë barrën e provës për të justifikuar origjinën e ligjshme të pasurisë së tyre dhe për të provuar mungesën e lidhjes së saj me produktet e veprës penale apo investimin e tyre.
173. Në konsideratë të këtyre parimeve dhe rregullimeve ligjore, një kopje e dosjes i është përcjellë Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë, me qëllim kryerjen e një hetimi pasuror ndaj shtetasve A. N. dhe P. P., në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9284, datë 30.09.2004, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar” (shkresa e Prokurorisë për Krime të Rënda, f. 1362 e vijues, në kuadër të korrespondencës me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, si dhe shkresa e depozituar në seancë).
174. Në lidhje me këtë shkak ankimi, trupi gjykues, nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të Komisionit, konstaton sa më poshtë.
175. Në datën 15.02.2011, prokurori Saimir Bahiti ka regjistruar procedimin penal për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, mbi bazën e kallëzimit penal të paraqitur nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Shkodër<sup>50</sup>, sipas të cilit shtetasit P. L. P. dhe A. Q. N., nëpërmjet transferimit të pasurive dhe kryerjes së transaksioneve financiare në vlera të konsiderueshme, dyshohet se synonin fshehjen ose mbulimin e origjinës së të mirave materiale, për të cilat ekzistonin dyshime se buronin nga veprimtari kriminale, për të cilat shtetasi A. N. vuante dënim në Gjermani. Sipas verifikimeve të kryera nga strukturat shtetërore kompetente për hetimin financiar<sup>51</sup>, kishte rezultuar se shtetasi A. N. dhe nëna e tij kishin kryer disa transaksione në vlera të konsiderueshme, të pajustificuara dhe me burim të dyshimtë.

---

<sup>50</sup> Sipas shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 11.01.2011, Drejtoria e Policisë së Qarkut Shkodër ka bërë me dije se Interpol Gjermani ka informuar Inteporl Tirana se shtetasi A. N., i biri i Q. dhe P., lindur më 15.04.1977 në Tiranë dhe banues në Shkodër, është arrestuar nga autoritetet e drejtësisë gjermane për shkelje të ligjit mbi lëndët narkotike më 01.04.2009.

<sup>51</sup> DPPP-jë Tiranë ka dhënë informacion të detajuar lidhur me transaksionet e dyshimta.

176. Pas regjistrimit të procedimit penal, subjekti ka urdhëruar kryerjen e një sërë veprimesh hetimore për marrjen e informacionit nga burimet përkatëse, lidhur me faktet dhe rrethanat që kanë të bëjnë me veprën penale për të cilën ishte regjistruar procedimi penal, duke përfshirë Interpol Tirana, institucionet bankare, ALUIZNI-n, DPSHTRR-në, QKR-në, ZQRPP-në, sistemin TIMS, Zyrën e Gjendjes Civile Shkodër dhe noterët publikë. Gjithashtu, për hetimin e çështjes është kërkuar ndihmë juridike në fushën penale nga autoritetet gjyqësore gjermane, holandeze dhe belge<sup>52</sup>.
177. Me vendimin e datës 26.03.2012, prokurori Saimir Bahiti ka vendosur sekuestrimin, në cilësinë e provës materiale, të praktikave noteriale të noterit A. K., si dhe të depozitave dhe transaksioneve të kryera nga shtetasit P. P., A. N., B. F., R. S. etj. Po kështu, me vendimin e datës 04.06.2012, prokurori Saimir Bahiti ka kërkuar sekuestrimin e praktikave të kontratave të shitblerjes për gjashtë apartamente banimi, që kishin si palë blerëse shtetasen P. P. dhe si palë shitëse shtetasen R. S..
178. Pas kërkesës së prokurorit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 29.05.2012, ka vendosur lëshimin e urdhrit të sekuestrimit preventiv për gjashtë pasuri të paluajtshme në emër të P. P., shtatë pasuri të paluajtshme në emër të R. S., si dhe dy llogari bankare pranë bankës BKT, në emër të P. P., urdhër i cili është ekzekutuar në bazë të urdhrit të datës 29.05.2012 të subjektit të rivlerësimit.
179. Më datë 07.01.2013, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2011, duke arsyetuar se, në rastin konkret, nga hetimi nuk kishte rezultuar e provuar që kapitalet monetare dhe pasuritë e tjera në emër të shtetasës P. P. dhe djalit të saj, A. N., të ishin produkt i ndonjë veprë penale. Sipas arsyetimit të vendimit, transaksionet bankare mbi bazën e të cilave kishin lindur dyshimet fillestare për ekzistencën e veprimeve të qëllimshme për fshehjen e origjinës së pasurisë së dyshuar si e ardhur nga veprimtaria kriminale në emër të shtetasit A. N., ishin kryer, sipas emërtimeve përkatëse, shumë kohë përpara se ky shtetas të ndalohej nga autoritetet gjermane. Gjithashtu, përveç informacionit të përcjellë nga autoritetet gjermane, sipas të cilit shtetasi A. N. vuante dënim për shkelje të legjislacionit mbi lëndët narkotike, nga hetimi nuk kishte rezultuar që ai të ishte dënuar për ndonjë veprë penale nga e cila mund të kishte prejardhur kapital monetar apo pasuri të tjera në emër të tij ose të familjarëve të tij. Sipas deklarimeve të shtetasës P. P., kapitali monetar, i cili më pas ishte investuar në pasuri të paluajtshme apo pasuri të tjera, ishte siguruar nga puna informale e saj dhe e familjes së saj gjatë emigracionit që prej vitit 1993.
180. Në datën 29.03.2013, Prokuroria e Përgjithshme i ka përcjellë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, aktet e ardhura nga autoritetet belge. Me vendimin e datës 01.04.2013, Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër P. K. ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. {\*\*\*}/2011, me arsyetimin se

<sup>52</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 06.02.2012, u është dërguar letërporosi autoriteteve gjyqësore holandeze, ku kërkohet informacion në lidhje me shtetasin A. N. (P.), vendbanimin, punësimin, të ardhurat nga puna, prona apo çdo aktivitet në emër të tij apo familjes etj.; dënime të tij në shtetin holandez dhe vendimet përkatëse; informacion mbi dënime të shtetasit Q. P. (babai); informacion në lidhje me P. P. (nëna), regjistrimin e saj atje, punësimin apo dënime të mundshme. Me shkresat nr. {\*\*\*}, datë 06.02.2012 dhe nr. {\*\*\*}, datë 06.02.2012 u është dërguar letërporosi përkatësisht autoriteteve gjyqësore gjermane dhe atyre belge.

përgjigjja e letërporosisë së dërguar autoriteteve belge, përmbante të dhëna të reja hetimore, të cilat duhej të përktheheshin dhe të vlerësoheshin në raport me të dhënat e tjera të administruara në dosje.

181. Me vendimin e datës 09.07.2013, prokurori Saimir Bahiti ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2011, duke arsyetuar se përgjigjja e letërporosisë drejtuar autoriteteve belge, nuk përmbante asnjë të dhënë me rëndësi për hetimin. Gjithashtu, subjekti ka parashtruar se autoritetet gjyqësore gjermane dhe holandeze nuk kishin kthyer ende përgjigje dhe ka vlerësuar se mungesa e të dhënave hetimore që do të rezultonin nga veprimet e këtyre autoriteteve, nuk e bënte të mundur zgjidhjen në themel të çështjes penale.
182. Me shkresën e datës 24.10.2013, Prokuroria e Përgjithshme i ka përcjellë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër aktet e dërguara nga autoritetet gjermane, ku jepeshin informacione mbi dënimin e shtetasit A. (N.) N. në këtë shtet, deportimin e tij nga Gjermania etj. Me vendimin e datës 25.10.2013, Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër B. C., ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit të procedimit penal, duke arsyetuar se përgjigjja e letërporosisë së dërguar autoriteteve gjermane, përmbante të dhëna të reja hetimore që lidheshin me procedimin dhe që duhej të përktheheshin e të vlerësoheshin së bashku me të dhënat e tjera të administruara në dosje.
183. Në datën 11.11.2013, prokurori Saimir Bahiti ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2011, duke arsyetuar se autoritetet gjermane nuk kishin përcjellë ndonjë informacion tjetër me rëndësi për hetimin, përveç atyre të kërkuara në letërporosinë drejtuar këtyre autoriteteve. Ai ka arsyetuar gjithashtu se mungesa e të dhënave hetimore nga autoritetet gjyqësore holandeze, nuk e bënte të mundur zgjidhjen në themel të çështjes penale.
184. DPPPP-ja ka paraqitur ankim ndaj vendimit të subjektit për pushimin e procedimit penal. Pas shqyrtimit të këtij ankimi nga Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën e datës 04.03.2016 drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, është konstatuar se kjo prokurori kishte kryer të gjitha veprimet e mundshme dhe të nevojshme hetimore deri në pritje të përgjigjes së letërporosisë nga autoritetet holandeze, si dhe është kërkuar ripërsëritja e kërkesës drejtuar autoriteteve gjermane për sigurimin e vendimit të Gjykatës së Landit Frankenthal, datë 04.12.2009, informacion mbi të dhëna të tjera me rëndësi për hetimin, si dhe rikujtimi për përshpejtimin e kthimit të përgjigjes së letërporosisë nga autoritetet holandeze.
185. Mbi bazën e kësaj shkrese, me vendimin e datës 08.03.2016, Drejtuesi i Prokurorisë Shkodër G. Sh. ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. {\*\*\*}/2011 dhe vazhdimin e hetimeve sipas orientimeve të Drejtorisë Task-Forcë në Prokurorinë e Përgjithshme. Më tej, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 06.05.2016, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme për të kërkuar informacion nëse autoritetet gjyqësore holandeze kishin kthyer përgjigje ndaj letërporosisë dhe, në mungesë të saj, për t'u dërguar një kujtesë këtyre autoriteteve. Ndërsa me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 10.05.2016, i është kërkuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme ndihmë juridike nga autoritetet gjermane në kuadër të procedimit penal nr. {\*\*\*}/2011. Me shkresat e datave 17.05.2016 dhe 24.05.2016, Ministria e Drejtësisë ka përsëritur kërkesën drejtuar autoriteteve holandeze dhe gjermane.

186. Në datën 26.05.2016, prokurori Saimir Bahiti ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2011. Në këtë vendim, pasi ka parashtruar se kishte kryer veprimet hetimore të kërkuara, duke u dërguar letërporosi autoriteteve gjermane dhe shkresë kujtese autoriteteve holandeze, prokurori ka arsyetuar se mungesa e të dhënave hetimore, të cilat do të rezultonin nga veprimet e autoriteteve gjermane dhe holandeze dhe mbi bazën e të cilave do të vlerësohej nëse pasuritë e shtetasit A. N. dhe familjarëve të tij ishin ose jo produkt i ndonjë veprë penale, nuk e bënte të mundur zgjidhjen në themel të çështjes penale.
187. Pas kërkesës së Komisionit për identifikimin e titullarit që kishte ushtruar kontrollin në përfundim të procedimit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka informuar se titullari i institucionit që kishte kryer kontrollin e këtij procedimi penal ishte G. Sh., duke paraqitur edhe kopjen e kapakut të fashikullit të procedimit, në të cilën rezulton e shënuar data e arkivimit 14.09.2016.
188. Vëzhguesi ndërkombëtar, në gjetjen dhe opinionin e datës 07.12.2022, pjesë e akteve shkresore në dosjen e Komisionit, ka referuar se: (i) nuk rezulton urdhër për regjistrimin e emrit të personit të cilit i atribuohet vepra penale, sipas nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale, në kuadër të hetimit financiar; (ii) nuk është kërkuar informacion për shtetasin A. P. (mbiemri i mëparshëm i A. N. ishte P.); (iii) nuk është kryer hetim për bashkëshorten e tij; (iv) nuk është kryer hetim ose nuk rezulton informacion nga disa zyra të ZVRPP-së për pasuri të paluajtshme të regjistruara në emër të nënës, babait, tezes/hallës apo xhaxhait/dajës së A. N.; (v) nuk rezulton kërkesë drejtuar Ministrisë së Drejtësisë apo regjistrin noterial për kontrata noteriale ndërmjet A. N. (P.), P. P., Q. P. dhe palëve të treta; (vi) nuk rezulton kërkesë drejtuar institucioneve financiare jobankare për transaksione të mundshme ndërmjet shtetasve A. N. (P.), P. P. dhe palëve të treta; (vii) arsyetimi dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk përputhen me deklaratimet e personave të pyetur gjatë hetimit, konkretisht lidhur me deklaratimet e shtetasit I. V. për blerjen e apartamentit nga A. N. dhe transferimin e shumës në llogarinë e tij bankare, ndërsa subjekti në vendim i referohet shtetasit A. M., i identifikuar si I. V., pa qenë e qartë mënyra e këtij identifikimi; si dhe (viii) burimi i shumës prej 200.000 eurosh dhe i depozitave të tjera bankare, kishte mbetur i pavërtetuar, ndërsa shtetasja P. P. kishte deklaruar se këto të ardhura ishin krijuar nga puna e tyre si emigrantë të paligjshëm në Belgjikë, Gjermani dhe Holandë.
189. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni ka vërejtur se subjekti nuk duket të ketë kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të administruar të gjitha të dhënat e nevojshme me qëllim arritjen e një konkluzioni të drejtë mbi ekzistencën e elementeve të veprës penale, duke evidentuar, sipas Komisionit, mungesë të aftësive profesionale në kuptim të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016. Për këtë arsye, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime që do të provonin të kundërtën e këtyre konstatimeve. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim si ai i parashtruar në ankimin drejtuar Kolegjit.
190. Trupi gjykues i Kolegjit, në shqyrtim të sa më sipër, si dhe referuar pretendimeve e shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, lidhur me procedurat e ndjekura prej tij si prokuror i çështjes, vlerëson si vijon.

191. Në vendimet për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2011, subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer një analizë të plotë të fakteve dhe provave në raport me dispozitën ligjore të zbatuar për marrjen e vendimit. Argumentet e përdorura nga subjekti në këto vendime, janë në thelb të njëjta dhe nuk përputhen me të dhënat e administruara në materialin hetimor, informacionin e ardhur nga Zyra e Interpol Tirana, kallëzimin penal të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Shkodër, të dhënat e rezultuara nga hetimi financiar, si dhe informacionin e përcjellë nga autoritetet gjermane, sipas të cilit konfirmohej se shtetasi A. N. ishte arrestuar nga autoritetet gjermane dhe vuante dënim në Gjermani për shkelje të legjislacionit mbi trafikimin e lëndëve narkotike, pasi ishte kapur në flagrancë duke trafikuar 1,15 kg lëndë narkotike kokainë<sup>53</sup>.
192. Të dhënat paraprake, si dhe ato të administruara gjatë hetimit, nuk rezultojnë të kenë qenë të pamjaftueshme për krijimin e dyshimit të arsyeshëm mbi ekzistencën e elementeve që lidhen me veprën penale për të cilën ishte regjistruar procedimi penal nr. {\*\*\*}/2011. Këto të dhëna mbështeteshin edhe nga informacionet e përfuara nga autoritetet shtetërore kompetente, të cilat kishin konfirmuar kryerjen e transaksioneve financiare, si dhe faktin se shtetasi A. N. ishte ndaluar, proceduar penalisht dhe dënuar në Gjermani për trafikim të lëndës narkotike kokainë<sup>54</sup>.
193. Në këto rrethana, pas regjistrimit të kallëzimit penal, ishte detyrë e subjektit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, të kryente të gjitha veprimet hetimore të domosdoshme për zbardhjen e plotë të çështjes dhe të mos mjaftohej vetëm me elementet e materialit kallëzues, por të zhvillonte hetime të plota dhe të gjithanshme.
194. Referuar vendimit për pushimin e hetimit të datës 07.01.2013, subjekti ka arsyetuar se transaksionet e referuara në kallëzimin penal, ndërmjet shtetasve P. P., A. N. dhe personave të tjerë, janë kryer shumë kohë përpara se shtetasi A. N. të ndalohej nga autoritetet gjermane dhe se nga hetimi nuk kishte rezultuar ndonjë aktivitet kriminal prej nga mund të kishin buruar kapitalet monetare dhe pasuritë e tjera në pronësi të tyre.
195. Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues çmon se, në kuptim të nenit 287 të Kodit Penal<sup>55</sup>, vepra penale e “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” përfshin forma të

<sup>53</sup> Referuar nga subjekti i rivlerësimit në vendimet për pushimin e procedimit penal.

<sup>54</sup> Rasti është vënë në lëvizje në bazë të informacioneve të përfuara nga DPPP-ja, nga verifikimet e së cilës në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, bëhet me dije se pasuria e shtetasit A. N. dhe P. P. kap vlerën 420.000 euro në transaksione bankare dhe pasuri të paluajtshme.

<sup>55</sup> “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, nëpërmjet:

a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

c) fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

ç) kryerjes së veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave;

d) investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale;

dh) këshillimit, ndihmës, nxitjes ose thirrjes publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër; dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. Kur kjo vepër kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në

ndryshme të pastrimit të produkteve të veprës penale, siç janë këmbimi ose transferimi i pasurisë me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj. Për ekzistencën e kësaj vepre, penale, kërkohet të ekzistojë një lidhje ndërmjet veprës penale ose veprimtarisë kriminale nga e cila burojnë përfitimet e paligjshme dhe veprës së parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

196. Në këtë kuptim, duhet që fillimisht të ekzistojë një vepër penale pararendëse, nga e cila të jenë krijuar të ardhurat e paligjshme, pavarësisht nëse për atë vepër penale autori është marrë ose jo në përgjegjësi penale, nëse ka nisur ose jo procedimi penal, është paraqitur ose jo kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq, apo është dhënë ose jo një vendim përfundimtar. Ajo që ka rëndësi dhe është e domosdoshme, është që, nga ana objektive, të provohet se janë kryer veprime ose mosveprime kriminale nga të cilat janë gjeneruar të ardhura dhe përfitime të paligjshme.
197. Në rastin objekt shqyrtimi, rezulton e provuar se shtetasi A. N. është ndaluar dhe arrestuar nga autoritetet gjermane për vepra penale të lidhura me narkotikët në vitin 2009, çka provon se prej tij janë kryer veprime kriminale nga të cilat mund të jenë gjeneruar të ardhura dhe përfitime të paligjshme, të cilat logjikisht datojnë përpara momentit të arrestimit dhe dënimit të tij nga autoritetet gjermane.
198. Po kështu, nga të dhënat e përfuara gjatë hetimit financiar të kryer ndaj këtyre shtetasve, ka rezultuar se P. P. dhe A. N. kanë qarkulluar shuma të konsiderueshme monetare *cash*, burimi i të cilave ka mbetur i paqartë, fakt i pranuar edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit, për sa kohë që nga aktet e administruara në fashikullin e procedimit penal nuk rezulton e provuar se këto të ardhura kanë rrjedhur nga aktivitetet e ligjshëm apo nga punësimi i tyre në emigracion.
199. Nga ana tjetër, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit penal pa pritur informacionin e kërkuar nga autoritetet gjyqësore të huaja, informacion i cili do të mund të ndihmonte në sqarimin nëse veprimtaria kriminale e kryer nga shtetasi A. N. në Gjermani përbënte një rast të izoluar apo një aktivitet të vazhdueshëm kriminal. Pikërisht mbi bazën e këtyre të dhënave do të duhej të vlerësohej, për qëllime të hetimit, nëse pasuritë e transferuara dhe pasuritë e tjera të shtetasit A. N. dhe të familjarëve të tij përbënin produkte të ndonjë vepre penale.
200. Në këto kushte, praktika e ndjekur në mënyrë të përsëritur nga subjekti i rivlerësimit nuk vlerësohet e mbështetur në të dhënat e administruara gjatë hetimeve për këtë procedim penal dhe as në parashikimet e legjislacionit procedural penal.

---

*bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. E njëjta vepër, kur ka sjellë pasojë të rënda, dënohet jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet me burgim. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe kur: a) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person që nuk mund të merret si i pandehur ose që nuk mund të dënohet;*

*b) ndjekja penale për veprën, produktet e së cilës pastrohen, është parashkruar ose amnistuar;*

*c) personi që kryen pastrimin e produkteve është i njëjtë me personin që ka kryer veprën, nga e cila kanë rrjedhur produktet;*

*ç) për veprën penale, nga e cila kanë ardhur produktet, nuk është filluar asnjëherë çështja penale apo nuk është dhënë një dënim me vendim penal të formës së prerë;*

*d) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person, pavarësisht shtetësisë së tij, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe është njëkohësisht e dënueshme, si në shtetin e huaj, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë. Dijenia dhe qëllimi, sipas paragrafit të parë të këtij neni, nxirren nga rrethana faktive objektive”.*

201. Përveç sa më sipër, sikurse është referuar edhe në gjetjen dhe opinionin e datës 07.12.2022 të vëzhguesit ndërkombëtar, trupi gjykues konstaton se subjekti nuk ka bërë regjistrimin e emrit të personit të cilit i atribuohet vepra penale, në përputhje me parashikimet e nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale, pavarësisht se në kallëzimin penal të paraqitur nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Shkodër, ishin referuar me emër dhe mbiemër shtetasit P. L. P. dhe A. Q. N., për të cilët dyshohej se, nëpërmjet transferimit të pasurive dhe kryerjes së transaksioneve financiare në vlera të konsiderueshme, synonin fshehjen e origjinës së të mirave materiale për të cilat ngriheshin dyshime se ishin produkt i veprave penale.
202. Trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit, sipas të cilit emri i autorit të veprës penale regjistrohet vetëm pasi të provohet kryerja e veprës penale, nuk qëndron. Ky vlerësim mbështetet në parashikimet e nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale<sup>56</sup>, si dhe në qëndrimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të shprehur në vendimin nr. 3, datë 27.09.2002, ku është elaboruar kuptimi i termit “person të cilit i atribuohet vepra penale”. Sipas këtij vendimi: *Kur njoftuesi mendon se e di se kush është autori i veprës penale, prokurori shënon në regjistrin që mbahet për njoftimin e veprave penale, emrin e personit që tregon kallëzuesi se është ose mund të jetë autor i veprës penale. Nuk ka asnjë dyshim se ky emërtim i përket fazës fillestare të procedimit penal. Termi “person të cilit i atribuohet vepra penale”, i marrë në kontekstin e nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale dhe të momentit procedural në të cilin përdoret, nuk mund të barazohet as me termin “person ndaj të cilit zhvillohen hetime” dhe as me termin “i pandehur”. Emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale shënohet në regjistër vetëm në ato raste kur kallëzuesi mendon se e di se kush është autori i krimit. Por kjo nuk do të thotë se ai është vërtet autor i veprës penale. Nëse personi të cilit i atribuohet vepra penale është apo jo autor i saj, do të rezultojë nga një hetim i plotë, i gjithanshëm dhe në përputhje me ligjin.*
203. Për sa më sipër, pretendimi dhe njëkohësisht shpjegimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me mosregjistrimin e emrit të personit të cilit i atribuohet vepra penale, vlerësohet i pabazuar.
204. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për kundërshtimin si të gabuar të konkluzionit të Komisionit lidhur me mungesën e veprimeve hetimore, trupi gjykues vëren se Komisioni ia ka atribuar këtë konkluzion mungesës së hetimeve të kryera nga subjekti për shtetasin A. N. me mbiemrin e tij të mëparshëm, P., si dhe mungesës së hetimeve në lidhje me bashkëshorten dhe babanë e tij. Për këto rrethana, subjekti ka pretenduar, si gjatë hetimit administrativ, ashtu edhe në ankim, se Drejtoria Vendore e Policisë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë dhe DPPP-ja nuk kishin sjellë të dhëna të tjera përtej materialit fillestar, si dhe se hetimi në emër të shtetasit A. N. ishte ezauruar, pasi në rastet e ndryshimit të mbiemrit, personi vijon të mbajë të njëjtin numër identifikimi personal. Në këto kushte, sipas subjektit, nuk ka pasur mungesë hetimesh për këtë shtetas.
205. Në vlerësim të këtyre pretendimeve, trupi gjykues konstaton se, në kuadër të veprimtarisë hetimore të zhvilluar nga subjekti i rivlerësimit, sikurse është referuar edhe nga vëzhguesi

<sup>56</sup> Neni 287, Regjistrimi i njoftimit të veprave penale: “1. Prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe në të njëjtën kohë ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale. 2. Ndalohet publikimi i regjistrimeve të bëra deri në marrjen si të pandehur të personit që i atribuohet vepra penale”.

ndërkombëtar në gjetjen dhe opinionin e datës 07.12.2022, mungojnë hetime për shtetasin A. N. me mbiemrin e tij të mëparshëm, P.<sup>57</sup>. Referuar kërkesave për informacion të dërguara nga subjekti ndaj institucioneve financiare dhe institucioneve të tjera shtetërore në Shqipëri, shtetasi A. N. është identifikuar vetëm me emër, atësi, mbiemër (N.) dhe datëlindje, pa u përfshirë mbiemri i mëparshëm apo numri i identifikimit personal.

206. Në këto kushte, pretendimi i subjektit se veprimet hetimore janë ezauruar, vlerësohet i pabazuar, për sa kohë që në kërkesat e hartuara për nevoja të hetimit, nuk është referuar as mbiemri i mëparshëm dhe as numri personal i identifikimit<sup>58</sup>. Po kështu, megjithëse nga përgjigjja e letërporosisë së autoriteteve gjyqësore belge subjekti i rivlerësimit ishte informuar për emrin e bashkëshortes së shtetasit A. N., nuk rezulton të jenë kryer veprime hetimore në lidhje me këtë shtetase.
207. Për sa më sipër, trupi gjykues e gjen të bazuar përfundimin e Komisionit se moskryerja e veprimeve hetimore të plota në lidhje me të dyshuarin kryesor dhe personat e tij më të afërt evidenton mangësi serioze në drejtim të hetimit të çështjes.
208. Përveç sa më sipër, Komisioni, ashtu si edhe vëzhguesi ndërkombëtar kanë evidentuar mangësi edhe në drejtim të veprimeve të ndërmarra nga subjekti për identifikimin e shtetasit A. M. si I. V., pasi, sipas vlerësimit të tyre, subjekti është mjaftuar vetëm me referimin e shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 25.11.2011, të bankës BKT, sipas së cilës konfirmohet se transaksioni i datës 24.07.2007 ishte kryer nga shtetasi I. V., pa vijuar më tej me hetime shtesë në lidhje me identitetin e shtetasit A. M..
209. Në lidhje me sa më sipër, referuar akteve të administruara në fashikullin penal, rezulton se Komisioni e ka lidhur këtë konkluzion me deklarin e shtetasit I. V., i cili ka pohuar se kishte blerë një apartament nga shtetasi A. N. dhe, për këtë arsye, i kishte transferuar këtij të fundit shumën prej 38.000 eurosh, ndërsa vetë subjekti i rivlerësimit, në vendimin e tij, i referohet shtetasit A. M., i cili, sipas tij, rezulton të ketë kryer transaksione bankare për blerje banese nga shtetasja P. P..
210. Në lidhje me këtë konstatim, trupi gjykues vëren dhe vlerëson se Komisioni nuk e ka identifikuar qartësisht problematikën që lidhet me veprimtarinë hetimore të subjektit në kuadër të këtij procedimi penal. Po kështu, trupi gjykues çmon se, ndonëse nga aktet e administruara në fashikullin penal mbetet e paqartë nëse I. V. dhe A. M. janë i njëjti person apo dy persona të ndryshëm që kanë kryer veprime të ndryshme financiare, fakti që subjekti i rivlerësimit ka administruar shkresën e bankës BKT, në të cilën konfirmohet se transaksioni në fjalë është kryer nga shtetasi I. V., si dhe fakti që ky shtetas është marrë në pyetje nga subjekti i rivlerësimit më datë 28.06.2012, në cilësinë e prokurorit të çështjes, tregon se nuk kanë munguar veprimet

---

<sup>57</sup> Bazuar në të dhënat sipas certifikatës së lindjes për shtetasin A. N. të datës 24.10.2006, pjesë e fashikullit të procedimit penal nr. {\*\*\*}/2011, ky shtetas më datë 26.02.2004 ka ndryshuar mbiemrin nga P. në N.. Ndërkohë, referuar të dhënave të pasaportës me nr. {\*\*\*}, lëshuar më datë 29 prill 2006, ky shtetas mban mbiemrin N..

<sup>58</sup> Në letërporositë e drejtuara autoriteteve gjyqësore belge, gjermane dhe holandeze, subjekti ka kërkuar informacion mbi këtë shtetas me gjeneralitetet A. N. (P.) dhe autoritetet gjermane kanë kthyer përgjigje për shtetasin A. (N.) N. me të dy mbiemrat.

hetimore në drejtim të identifikimit të këtij shtetasi. Për rrjedhojë, përfundimi i arritur nga Komisioni në këtë aspekt, vlerësohet i pabazuar në faktet e administruara.

211. Sa i takon pretendimit të subjektit, me anë të të cilit ai kundërshton si të pabazuar konkluzionin e Komisionit në paragrafin 165 të vendimit, sipas të cilit, si pasojë e mungesës së një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, mbeti i paprovuar burimi i shumës prej 200.000 eurosh, trupi gjykues vëren se, referuar akteve të fashikullit penal, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka marrë në pyetje shtetasen P. P. lidhur me të ardhurat e transferuara/depozituara në llogaritë e saj bankare. Në deklaratimet e saj, ajo është shprehur se, së bashku me bashkëshortin dhe djalin, kanë jetuar dhe punuar në emigracion. Ajo ka deklaruar gjithashtu se, gjatë qëndrimit në emigrim, janë prezantuar si shtetas kosovarë dhe kanë lëvizur në Gjermani, Holandë dhe Belgjikë, ku kanë kryer punë të ndryshme të padeklaruara për shkak të mungesës së dokumentacionit të rregullt. Sipas deklaratimeve të saj, të ardhurat e transferuara janë krijuar nga puna në emigracion dhe më pas janë investuar në Shqipëri.
212. Mbi bazën e këtyre deklaratimeve, subjekti i rivlerësimit u është drejtuar autoriteteve gjyqësore gjermane, holandeze dhe belge, duke kërkuar verifikime dhe informacion lidhur me regjistrimin e shtetasve A. N., P. P. dhe Q. P. në këto shtete, kohën e qëndrimit të tyre, punësimin, të ardhurat e siguruar nga puna apo çdo aktivitet tjetër ekonomik, si dhe pronat, pasuritë dhe llogaritë bankare në emër të tyre.
213. Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues konstaton se, në çdo rast, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit penal mbi bazën e nenit 328, pika 1, shkronja “dh” e Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit: “del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai”, pa pritur përgjigjet e autoriteteve gjyqësore të huaja, të cilat do të mund të jepnin informacion të vlefshëm për nevojat e hetimit në këtë procedim penal, ndërkohë që mund të vijonte hetimet për sa kohë që afati hetimor nuk ecte, në kushtet kur në regjistrin e njoftimit të veprave penale nuk ishte regjistruar emri i personit ndaj të cilit zhvilloheshin hetimet.
214. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se kjo mënyrë veprimi evidenton mangësi të subjektit të rivlerësimit në drejtim të kryerjes së një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm.
215. Sa i takon pretendimit të subjektit se vendimet për pushimin e procedimit penal janë kontrolluar nga drejtuesit e tij dhe nuk janë vlerësuar si të gabuara, si dhe se procedura hetimore është kontrolluar dhe vlerësuar edhe nga Drejtoria Task-Forcë pranë Prokurorisë së Përgjithshme, e cila nuk ka konstatuar mangësi në hetime, trupi gjykues vlerëson se, referuar akteve të administruara në fashikull, nuk rezulton që ndonjë prej drejtuesve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër të ketë kryer një vlerësim konkret lidhur me mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Në çdo rast, prokurori nuk mund të shmanget nga përgjegjësia e tij për vendimmarrjen dhe kryerjen e veprimtarisë hetimore, pavarësisht qëndrimit që ka mbajtur drejtuesi në kontrollin potencial.
216. Nëpërmjet shkresës “Kthim përgjigje” të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, është bërë me dije se titullari që ka ushtruar kontrollin përfundimtar mbi dosjen e procedimit penal nr. {\*\*\*/2011, ka qenë drejtuesi G. Sh.. Bashkëlidhur kësaj shkrese, është përcjellë edhe kopja e kapakut të dosjes së procedimit penal nr. {\*\*\*/2011, në të cilën

evidentohet firma e drejtuesit dhe data e arkivimit, por nuk rezulton të jetë kryer ndonjë vlerësim konkret mbi mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

217. Sa i takon shkresës nr. {\*\*\*}, datë 04.03.2016, të Drejtorisë Task-Forcë pranë Prokurorisë së Përgjithshme, të referuar nga subjekti në mbështetje të pretendimit të tij se hetimi i këtij procedimi penal është kontrolluar nga kjo drejtori, e cila ka shqyrtuar ankimin e DPPP-së kundër vendimit të pushimit të procedimit penal të marrë nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se, referuar përmbajtjes së kësaj shkrese, Drejtoria Task-Forcë, pas shqyrtimit të ankimit, ka vlerësuar se nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër janë kryer të gjitha veprimet e mundshme dhe të nevojshme hetimore deri në pritje të kthimit të përgjigjes së letërporosisë nga autoritetet gjyqësore holandeze.
218. Megjithatë, referuar përmbajtjes dhe datës së kësaj shkrese<sup>59</sup>, e cila mban datën 04.03.2016, nuk rezulton e qartë se cilin prej vendimeve të subjektit për pushimin e çështjes, ka marrë në shqyrtim Drejtoria Task-Forcë, për sa kohë që, pas dërgimit të kësaj shkrese pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, subjekti ka marrë edhe një vendim tjetër për pushimin e procedimit penal, konkretisht atë të datës 26.05.2016.
219. Për sa më sipër, vlerësimi i bërë nga Drejtoria Task-Forcë nuk mund të konsiderohet përcaktues për tërësinë e hetimeve të kryera, por vetëm për një pjesë të tyre, ndaj pretendimi i subjektit lidhur me kontrollin e ushtruar mbi veprimtarinë hetimore në procedimin penal nr. {\*\*\*}/2011, nuk vlerësohet i bazuar.
220. Në çdo rast, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje se institucionet e rivlerësimit, bazuar në kompetencat e tyre kushtetuese dhe ligjore në kuadër të këtij procesi, nuk janë të detyruara ta mbështesin vlerësimin e tyre mbi kontrollin e ushtruar nga organet e zakonshme të vlerësimit apo mbikëqyrjes.
221. Në përfundim të kësaj analize, trupi gjykues e gjen të drejtë e të bazuar konkluzionin e Komisionit në lidhje me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2011.
- *Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë:*
222. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën (-) 736.659 lekë, për krijimin e pasurisë apartament banimi në rrugën “{\*\*\*}” në Tiranë, duke pretenduar se ka arritur nivel të besueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe se rezultati për këtë kriter nuk mund të merret në vlerësim as si shkak për aplikimin e masës disiplinore të parashikuar në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
223. Këtë shkak ankimi, subjekti e bazon në pretendimin se analiza financiare e personit tjetër të lidhur S. A., për burimet financiare të krijimit të shumës 1.200.000 lekë të dhënë hua, duhet të

---

<sup>59</sup> Në këtë shkresë, me lëndë “Kthim dosje”, Drejtoria Task-Forcë pranë Prokurorisë së Përgjithshme është shprehur se “pas shqyrtimit të ankimit ndaj vendimit të procedimit penal nr. {\*\*\*}/2011 [...]”, por nuk ka referuar se ndaj cilit vendim pushimi është kryer ankimi dhe, bashkëlidhur akteve në fashikullin e procedimit penal, nuk ndodhet ankimi i DPPP-së.

përfshijë vetëm këtë shumë dhe jo pasuritë e tjera të tij, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 84/2016 dhe jurisprudencën e Kolegjit.

224. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit në raport me arsyetimin e vendimit objekt kontrolli dhe pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit në ankim, konstaton si më poshtë.
225. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar: *Pasuria me nr. {\*\*\*}, nr. {\*\*\*} Z. Kadastrale. Lloji i pasurisë “apartament” me sipërfaqe 87,3 m<sup>2</sup> dhe 73,5m<sup>2</sup> verandë. Adresa: “{\*\*\*}”, ish-Kompleksi {\*\*\*}, Tiranë. Kontrata e shitblerjes me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 27.07.2012. Vlera 104.000 euro. Pjesa takuese 50%.*
226. Si burim krijimi për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:
- 3.000.000 lekë depozitë në Raiffeisen Bank, në emër të subjektit ku janë depozituar pagat.
  - 50.000 euro hua nga z. P. G., me kontratë huaje nr. {\*\*\*} rep., {\*\*\*} kol., datë 04.0.2012.
  - 3.000.000 lekë hua nga z. I. H. e cila është likuiduar plotësisht dhe si burim krijimi ka deklaruar: (i) pagat e dy bashkëshortëve; dhe (ii) 10.000 euro dhuratë nga vjehrra.
  - 1.200.000 lekë hua nga z. S. A.. Shkresë e thjeshtë, lëshuar me shkrim dore nga S. A., datë 01.07.2012 dhe deklaratë noteriale me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 21.12.2016.
227. Komisioni, në përfundim të kontrollit lidhur me burimet financiare të subjektit të rivlerësimit për krijimin e kësaj pasurie, ka vlerësuar se: *[...] pas rishikimit të analizës financiare, kjo balancë bëhet -736.659 lekë, pasi ashtu sikurse është arsyetuar më sipër në këtë vendim: (i) shuma 21.493,55 euro paguar pranë BKT-së në datën 3.12.2012, nuk u konsiderua si shpenzim i subjektit mbi shumën 104.000 euro; (ii) huaja prej shtetasit S. A., në vlerën prej 1.200.000 lekësh, marrë në vitin 2012, nuk u konsiderua si burim i ligjshëm për blerjen e pasurisë apartament. Kjo balancë nuk konsiderohet penalizuese në vlerësimin e kriterit pasuror.*
228. Këtë vlerësim, Komisioni e ka mbështetur në konstatimin se huadhënësi nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e huasë në shumën 1.200.000 lekë në vitin 2012, në kuptim të parashikimeve të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Në këtë kuadër, Komisioni ka vlerësuar të mos marrë në konsideratë pretendimet e subjektit se likuiditetet bankare të huadhënësit ekzistonin në momentin e dhënies së huasë dhe, për këtë arsye, ato ishin përfshirë në analizën financiare të tij deri në momentin e dhënies së huasë.
229. Sa i takon shumës prej 3.100.000 lekësh, të përfituar nga babai i huadhënësit rreth 12 vite përpara dhënies së huasë, Komisioni ka vlerësuar se, referuar kohës së largët të përfitimit të kësaj shume, nuk rezultojnë bindëse pretendimet e subjektit se kjo shumë është përdorur për dhënien e huasë ose se ajo është përfituar tërësisht nga huadhënësi S. A..
230. Subjekti, gjatë procesit në Komision, ka pretenduar, sikurse edhe në ankim, se analiza financiare e huadhënësit S. A., në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë së burimit të shumës së dhënë hua, duhet të përfshijë vetëm shumën objekt të huasë dhe jo shtesën e likuiditeteve bankare, pasi këto të fundit, sipas tij, nuk përbëjnë pasuri të huadhënësit, por të familjarëve të tij.

231. Po kështu, subjekti ka pretenduar se në analizën financiare duhet të përfshihet edhe shuma prej 3.100.000 lekësh, si e ardhur e përfituar nga shitja e pasurive të paluajtshme nga babai i huadhënësit. Sipas subjektit, nëse analiza financiare do të kryhej në përputhje me standardet e përcaktuara në jurisprudencën e Kolegjit, atëherë huadhënësi S. A. do të rezultonte me mundësi financiare për krijimin e të ardhurave të dhëna hua subjektit dhe, për rrjedhojë, shuma prej 1.200.000 lekësh duhej të konsiderohej burim i ligjshëm për krijimin e pasurisë “apartament banimi”.
232. Trupi gjykues, lidhur me kufijtë e shtrirjes së kontrollit mbi pasurinë e huadhënësit, z. S. A., e gjen të drejtë pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ky kontroll duhet të përfshijë vetëm shumën e dhënë hua, pa përfshirë likuiditetet bankare të huadhënësit në momentin e dhënies së huasë.
233. Referuar jurisprudencës së Kolegjit, subjekti i rivlerësimit mban barrën për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës së dhënë hua nga personi tjetër i lidhur, sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, vetëm në lidhje me këtë shumë konkrete dhe jo edhe për pasuritë e tjera të huadhënësit.
234. Nga kontrolli që trupi gjykues i bëri analizës financiare të Komisionit, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, rezultoi se personi tjetër i lidhur, z. S. A., kishte burime financiare të ligjshme për krijimin e shumës prej 1.200.000 lekësh, të dhënë hua subjektit. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk rezulton me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë “apartament banimi”.
- *Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës:*
235. Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit, duke pretenduar se mangësitë e konstatuara i referohen kriterit të aftësive profesionale, pasi për këtë kriter Komisioni nuk ka gjetur mangësi të ankuesit dhe ai nuk ka pasur barrë prove. Subjekti pretendon se ka arritur nivel të besueshëm për kriterin e kontrollit të figurës. Në këto kushte, asnjë gjetje në lidhje me këtë kriter nuk mund të shërbejë as si vlerësim i veçantë i këtij kriteri dhe as si vlerësim tërësor për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit.
236. Nga aktet e çështjes, rezulton se DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit nëpërmjet verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e kontakteve të mundshme të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në përputhje me parimet dhe kushtet e parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.
237. DSIK-ja i ka përcjellë Komisionit raportin lidhur me këtë kontroll për subjektin e rivlerësimit me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 02.11.2017, raport i cili është deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 06.02.2020, të KDZH-së, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Sipas këtij raporti, grupi i punës pranë DSIK-së kishte arritur në përfundimin se subjekti ishte i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.
238. Më tej, në funksion të një hetimi të pavarur dhe, nisur edhe nga informacionet konfidenciale të organeve ligjzbatuese, Komisioni ka kërkuar përditësimin e informacionit nga DSIK-ja. Në

përgjigje të kësaj kërkesë, DSIK-ja ka përcjellë raportin<sup>60</sup> nr. {\*\*\*} prot., datë 10.10.2022, për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Saimir Bahiti, raport i cili është deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 25.10.2022, të KDZH-së.

239. Në përfundim, grupi i punës pranë DSIK-së ka ndryshuar konstatimin fillestar, duke kaluar nga vlerësimi për përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në konkluzionin për papërshtatshmëri të subjektit të rivlerësimit Saimir Bahiti për vazhdimin e detyrës.
240. Në përfundim të vlerësimit të kriterit të kontrollit të figurës, Komisioni ka konkluduar se: *bazuar në standardet e kontrollit të figurës të parashikuar në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, nuk mund të arrijë në përfundimin se subjekti është i papërshtatshëm për vijimin e detyrës. Pavarësisht këtij konkluzioni, duke qenë se nga analiza e trajtimit të çështjeve penale për të cilat ka pasur informacione konfidenciale, janë evidentuar disa problematika gjatë ushtrimit të detyrës nga subjekti, mangësitë e konstatuara janë marrë në konsideratë nga Komisioni në vlerësimin tërësor të çështjes gjatë procesit të vendimmarrjes.*
241. Subjekti i rivlerësimit, kundërshtimin e vlerësimit të Komisionit për këtë kriter, e ka bazuar në pretendimin se mangësitë e konstatuara në vendimin e Komisionit, i referohen kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale dhe asnjë gjetje në lidhje me këtë kriter nuk mund të shërbejë as si vlerësim i veçantë dhe as në vlerësimin tërësor për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit ndaj tij.
242. Këtë pretendim, subjekti e bazon në jurisprudencën e Kolegjit, sipas vendimit nr. 20, datë 08.09.2020, në të cilin argumentohet: *[...] është e pamundur që në kuadër të vlerësimit të figurës të zbatohen standardet e kontrollit të aftësive profesionale, pasi burimet mbi të cilat merren informacionet për kontrollin e këtyre kriterëve të rivlerësimit, janë të ndryshme, gjithashtu i ndryshëm është edhe objekti i kontrollit. Në nenin 71 të ligjit nr. 96/2016 përcaktohen kriteret mbi të cilat kryhet vlerësimi profesional, të cilat janë: aftësitë profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit; aftësitë organizative; etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit; aftësitë personale dhe angazhimi profesional. Në këtë këndvështrim, në kuadër të vlerësimit të kriterit të figurës, e cila ka standarde të posaçme të kontrollit sipas nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, nuk mund të aplikohen standardet e kontrollit të kriterit të aftësive profesionale.*
243. Në vlerësim e këtij shkak ankimi, trupi gjykues vëren se Komisioni, në konkluzionin e tij në lidhje me kontrollin e figurës, është shprehur në vendim se: *bazuar në standardet e kontrollit të figurës të parashikuar në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, nuk mund të arrihet në konkluzionin se subjekti është i papërshtatshëm.*

---

<sup>60</sup> Në përmbajtje të këtij raporti, referohen të dhëna për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme të subjektit, si veprime korruptive, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës, me qëllim dhënien e vendimeve për pushimin e hetimeve në favor të një pale, si dhe kontakte të papërshtatshme, jorastësore, me persona të përfshirë në afëra korruptive, pjesë e të cilave është edhe vetë subjekti si përfitues i shumave monetare, kundrejt pushimit të hetimeve në shkelje të ligjit.

244. Referuar konkluzionit të mësipërm, rezulton se problematikat e evidentuara nga kontrolli dhe vlerësimi i disa çështjeve penale<sup>61</sup>, për të cilat ka pasur informacione konfidenciale nga institucionet ligjzbatuese, janë marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes, bazuar në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit<sup>62</sup>, dhe nuk janë trajtuar si rrethana të cilat e bëjnë subjektin e rivlerësimit të papërshtatshëm sa i përket kriterit të kontrollit të figurës.
245. Problematikat e konstatuara lidhur me disa procedime penale janë analizuar më sipër në këtë vendim në shkakun e ankimit që lidhet me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.
- *Në lidhje me cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë:*
246. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra është dhënë vetëm mbi bazën e përfundimeve të arritura për kriterin e aftësive profesionale. Sipas tij, zbatimi i nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 duhet të ndodhë vetëm për shkelje që, në vetvete, nuk përbëjnë shkaqe për aplikimin e rasteve të tjera të shkarkimit, të parashikuara nga pikat 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni. Në këtë kuptim, subjekti pretendon se cenimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të kësaj dispozite, duhet të mbështetet në një vlerësim tërësor të tri kriterëve të rivlerësimit ose në një vlerësim të përgjithshëm të procedurave në raport me sjelljen e subjektit gjatë procesit, dhe jo në një analizë të veçuar vetëm mbi kriterin e aftësive profesionale.
247. Subjekti pretendon gjithashtu se vendimi duhet të mbështetet vetëm në prova të qëndrueshme dhe të jetë objektivisht i justifikuar, bazuar në një vlerësim të paanshëm dhe mbi kritere objektive, e jo mbi vlerësime subjektive të autoritetit shtetëror. Sipas tij, qëndrimi dhe zgjidhja e dhënë duhet të jenë të argumentuara dhe të analizuara në mënyrë të tillë që të shpjegohet konkretisht shkelja dhe mënyra se si është cenuar potencialisht besimi i publikut te sistemi i drejtësisë. Po ashtu, ai pretendon se duhet të argumentohet bindshëm dhe në një nivel të kënaqshëm se ky cenim është i konsiderueshëm dhe i perceptueshëm nga publiku i gjerë.
248. Më tej, subjekti pretendon se vetë ligji nr. 84/2016 paraqet mangësi për sa i përket qartësisë dhe kuptueshmërisë së kriterëve që përcaktojnë sjellje të afta për të cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, si dhe ka përcaktime të kufizuara në lidhje me indikatorët dhe nënindikatorët mbi bazën e të cilëve duhet të kryhet vlerësimi tërësor i procedurave. Sipas tij, ligji nuk parashikon as kritere konkrete mbi të cilat duhet të matet niveli i cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.
249. Në përfundim, subjekti pretendon se ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe në kriterin e kontrollit të figurës, si dhe se Komisioni nuk ka bërë një vlerësim negativ për kriterin e aftësive profesionale, për sa kohë ndaj tij nuk është zbatuar neni 61, pika 4

---

<sup>61</sup> Komisioni nuk ka përcaktuar se cilat çështje janë marrë në analizë sipas informacionit bazuar në të dhënat konfidenciale, por në rubrikën e vendimit “Informacione të marra pranë agjencive ligjzbatuese dhe institucione të tjera”, ka trajtuar rastin S. dhe rastin N..

<sup>62</sup> Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 9/2018 (JR), paragrafi 44; nr. 11/2018 (JR), paragrafi 5; nr. 2/2019 (JR), paragrafi nr. 35.2; nr. 15/2019 (JR), paragrafi 119; nr. 34/2019 (JR), paragrafi nr. 55.1.

e ligjit nr. 84/2016 si shkak shkarkimi. Referuar parashikimeve të ligjit nr. 84/2016 dhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit, subjekti pretendon se nuk mund të shkarkohet mbi bazën e nenit 61, pika 5 e këtij ligji, duke u mbështetur vetëm në analizën e kriterit të aftësive profesionale dhe, për rrjedhojë, shkarkimi i tij është i pabazuar në faktet e çështjes dhe në ligj.

250. Në lidhje me këtë shkak ankimi, trupi gjykues vlerëson se zbatimi i nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si një nga rastet e shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, gjen zbatim kur, nga vlerësimi tërësor në kuptim të nenit 4, pika 2 e këtij ligji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës.
251. Në interpretim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, që cenimi i besimit të publikut të konsiderohet i ndodhur, i arsyeshëm, i konsiderueshëm dhe i perceptueshëm si i tillë, duhet të evidentohen shkelje ligjore të cilat, megjithëse nuk përbëjnë shkak për aplikimin e rasteve të tjera të shkarkimit të parashikuara nga pikat 1, 2, 3 dhe 4 të nenit 61 të këtij ligji, janë të natyrës së tillë që cenojnë integritetin, etikën profesionale dhe besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.
252. Për sa kohë që shkeljet e konstatuara në kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe sjellja e subjektit të rivlerësimit nuk janë konsideruar të tilla që të mjaftojnë për ta kualifikuar situatën faktike sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit se çështjet e mësipërme duhet të trajtohen si një situatë e kualifikueshme sipas parashikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
253. Kjo, për sa kohë nga provat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit, janë evidentuar fakte dhe rrethana që bien ndesh me vlerat themelore, standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes, si dhe hedhin dyshime mbi integritetin dhe etikën profesionale të subjektit të rivlerësimit, elemente të cilat ndikojnë në perceptimin e publikut mbi integritetin, përgjegjshmërinë dhe seriozitetin e organeve të drejtësisë, duke cenuar kështu besimin e publikut në to.
254. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi mbi bazën e akteve të përcjella nga Komisioni, si dhe pasi u njoh në datën 21.07.2025, në mënyrë të drejtpërdrejtë me informacionin e klasifikuar mbi të cilin vëzhguesi ndërkombëtar i çështjes ka mbështetur gjetjen dhe opinionin e datës 07.12.2022, informacione këto të njohura dhe të vlerësuara edhe nga Komisioni në vendimin objekt kontrolli, si dhe analizoi shkaqet e ankimit sikurse është arsyetuar më sipër në këtë vendim, në përfundim i gjeti të drejta konkluzionet e Komisionit se:
- Në procedimin penal nr. {\*\*\*/2010 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, urdhrat e subjektit të rivlerësimit për zgjatjen e afatit të hetimeve kanë qenë të pajustificuara në raport me kushtet e parashikuara në nenin 324/2 të Kodit të Procedurës Penale. Në to nuk parashikohen veprimet hetimore konkrete që nevojitet të kryhen, si dhe ka mungesë veprimesh hetimore në afatin e shtyrë.
  - Në procedimin penal nr. {\*\*\*/2014 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe në procedimin penal nr. {\*\*\*/2011 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetime të plota e të gjithanshme dhe ka ndërmarrë veprime procedurale të pabazuara në situatën faktike dhe legjislacionin procedural.

- Subjekti i rivlerësimit ka cenuar etikën e funksionarit të sistemit të drejtësisë për shkak të: (i) udhëtimit me shtetasin P. M., të proceduar penalisht prej tij në procedimin penal nr. {\*\*\*}/2010 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; (ii) marrjes së huasë prej 50.000 eurosh pa interes dhe për një afat të gjatë nga shtetasi P. G., ndaj të cilit rezultoi se më parë, në ushtrim të funksionit të prokurorit, ka kryer veprime procedurale verifikuese në kuadër të procedimit penal nr. {\*\*\*}/2009 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

255. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues gjeti të drejtë edhe konkluzionin përfundimtar të Komisionit se subjekti i rivlerësimit Saimir Bahiti ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, sipas parashikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

256. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se vendimi i Komisionit objekt kontrolli është i bazuar në fakte e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

### **VENDOSI:**

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 612, datë 13.01.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Saimir Bahiti.
- Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 21.07.2025.

**ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**RELATOR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*